

Decentralization and Local Development Programme (dldp)  
Mbështetja ndaj Bashkisë Lezhë për planin afatshkurtër  
dhe planin e integruar të menaxhimit të mbetjeve.

# Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2017-2021 Bashkia Lezhë



Hartuar nga:  
Instituti i Kërkimeve Urbane



Urban Research Institute

Dhjetor 2016



## Mirënjohje

Plani i Menaxhimi të Integruar të Mbetjeve Urbane 2017 – 2021 për Bashkinë Lezhë është hartuar në bashkëpunim nga Bashkia, Instituti i Kërkimeve Urbane dhe mbështetjen e DLDP dhe Helvetas Swiss Intercooperation.

Autoret që kanë hartuar këtë dokument ing. Edlir Vokopola, MSc. Entela Kallamata dhe ing. Dritan Gorica nga Instituti i Kërkimeve Urbane, i shprehin mirënjohjen për bashkëpunimin dhe mbështetjen në mënyrë të veçantë kryetarit të Bashkisë z. Fran Frrokaj, dhe kryetarit të Grupit të Punës z. Enver Hafizi, zv/kryetar i Bashkisë. Autorët i janë gjithashtu shume mirënjohës z. Petrit Marku, Drejtor i Programimit të Zhvillimit dhe anëtarëve të tjerë të Grupit të Punës në Bashki.

Në mënyrë të veçantë falënderojmë DLDP që mundësoi financimin e hartimit të këtij Plani, por veçanërisht znj. Valbona Karakaçi, drejtuese e projektit dhe ekspertin z. Arben Kopluku, për mbështetjen, bashkëpunimin dhe lehtësimin e të gjithë veprimtarisë. Dëshirojmë të veçojmë gjithashtu dhe të shprehim mirënjohjen tonë edhe për konsulentet z. Felix Schmidt dhe znj. Emilie Gax nga SDC, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm kanë asistuar të gjithë procesin.





## Fjala e kryetarit

Të nderuar bashkëqytetarë!

Mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta urbane janë një objektiv parësor i bashkisë. Në territorin e bashkisë gjenden burime të rëndësishme natyrore të cilat kanë statusin e zonave të mbrojtura si laguna Kune-Vain - Tale, rreth 30 km vijë bregdetare në detin Adriatik, dhe një rrjet hidrik i pasur me jetë.

Zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë së gjelbër përbëjnë potenciale të rëndësishme për përmirësimin e nivelit të jetesës së qytetarëve Lezhjanë. Këto veprimtari do të zhvillohen duke ruajtur e konsoliduar këto burime natyrore të rëndësishme nëpërmjet një mjedisi më të pastër dhe shfrytëzimi racional të tyre.

Bashkia e Lezhës është e qartë dhe kupton se menaxhimi i integruar i mbetjeve është një sfidë shumë ambicioze, por njëkohësisht është dhe një kusht që duhet përmbushur domosdoshmërisht për të mundur një mjedis të pastër dhe ekonomi të qëndrueshme.

Nëpërmjet Planit për Menaxhimin e Integruat të Mbetjeve 2017 – 2021, bashkia do të synojë grumbullimin e mbetjeve në të paktën 95 % të territorit dhe do të përmbushë të gjitha detyrime për reduktimin deri në 50 % të mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit, kështu do të arrijë të gjitha objektivat kombëtare dhe kriteret e integritimit Evropian.

Përmbushja e këtyre objektivave është e kushtueshme, ajo kërkon, kohë, përkushtimin tonë por edhe të qytetarëve lezhjanë. Ne e kuptojmë se krahas vendosjes së një sistemi efektiv për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, është e rëndësishme që qytetarët të bëhen pjesë e këtij përkushtimi. Bashkia nuk do të kursejë për të investuar në edukimin, ndërgjegjësim dhe pjesëmarrjen qytetare, ashtu sikundër ne do të bëjmë transparente të gjitha vendimet tona, për të mundur një rol sa më të madh të qytetarëve në zbatimin e këtij Plani.

Nëpërmjet këtij mesazhi i bëj thirrje të zgjedhurve vendor, administratës vendore dhe qendrore në Lezhë, si dhe të gjithë qytetarëve që me përkushtim të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për ta bërë këtë Plan një realitet dhe ta kthejmë Lezhën në një bashki të gjelbër dhe miqësore me mjedisin.

Me respekt,

**Fran Frrokaj**

Kryetari i bashkisë Lezhë

## Akronime

ARM	- Agjencia Rajonale e Mjedisit
BE	- Bashkimi Evropian
<i>dldp</i>	- <i>Decentralization Local Development Programme</i>
GNE	- Grupi i Ndërgjegjesimit dhe Edukimit
GP	- Grupi i Punës
IKU	- Instituti i Kërkimeve Urbane
M&V	- Monitorimi dhe Vlerësimi
NJ. A	- Njësi administrative
ORM	- Objekti i Reduktimit të Mbetjeve
PGM	- Pika Grumbullimi të Mbetjeve
PMIM	- Plani Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
QNMR	- Qendra e Ndarjes Mbetjeve të Riciklueshme
QQ	- Qeveria Qendrore
RGJC	- Regjistri i Gjendjes Civil
Rr. Gj. C	- Rregjistri i Gjendjes Civile

## Parantezë

Hartimi i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane 2017 – 2021 (PMIM) në bashkinë Lezhë është hartuar duke u mbështetur mbi një analizë të gjëndjes aktuale, të karakterisitkave kryesore që lidhen elementët e planifikimit si dhe në përputhje me legjislacionin, dokumentat strategjike dhe syminet e Shqipërisë në procesin e integritimit Evropian.

Analiza ka evidentuar problematikat kryesore sic janë renditur më poshtë:

- Nivel i ulët i mbulimit me grumbullimin e mbetjeve dhe standardid të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta
- Nivel i ulët i riciklimit
- Kosto të larta të transportit
- Niveli i ulët i mbulimit të kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit
- Edukim dhe ndërgjegjësim i pamjaftueshëm,
- Investime kapitale të munguara

Bashkia e Lezhës është e qartë dhe kupton se menaxhimi i integruar i mbetjeve është një sfidë shumë ambicioze.

Nëpërmjet zbatimit të PMIM, bashkia do të përballet me sfidat kryesore të cilat do të adresojnë çështjet në vijim:

- Arritja e mbulimit me grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të Bashkisë Lezhë.
- Ofrimi i shërbimit sipas hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve duke siguruar grumbullimin, reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin.
- Orjentimi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve nëpërmjet reduktimit, rritjes së riciklimit dhe rikuperimi.
- Përcaktimi i rolit të komunitetit të mbledhësve informal në sistemin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Krijimi i bazës së të dhënave për optimizmin e shërbimit.
- Zbatimi i parimit “ndotësi paguan”, rritja e të ardhurave nga tarifa drejt mbulimit të kostove të shërbimit

Në kuadër të këtij Plani është vlerësuar se arritja e objektivave në harkun kohor 2017 – 2021, do të kushtojë bashkisë Lezhë rreth 451,233,000 Lekë ose shumën ekuivalente prej 3,294,000 Euro. Plani sunon vendosjen e një sistemi efektiv për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve duke kombinuar disa mënyra, kontenerë, qese etj., përfshirë këtu investimet kapitale dhe mbulimin e kostove operacionale të cilat do të mbulohen kryesisht nga buxheti i bashkisë.

Për të rritur standardin dhe arritur objektivat në lidhje me reduktimin e mbetjeve, bashkia ka planifikuar ndërtimin e një Objekti për Reduktimin e Mbetjeve. Ky Objekt, me një vlerë totale prej rreth 3.5 milion Euro do të realizohet në tre faza, dy prej të cilave më shumë 1,89 milion Euro në harkun kohor 2017 – 2021 ndërsa faza e tretë me shumë 1.6 milion Euro do të zhvillohet përtej horizontit kohor të këtij Plani. Parashikohet që investimi i këtij objekti të realizohet në bashkëpunim nga bashkia, buxheti i shtetit dhe donacione.



## Përmbajtja

MIRËNJOHJE

FJALA E KRYETARIT

AKRONIME

PARANTEZË

LISTA E TABELAVE

LISTA E GRAFIKËVE

1.	HYRJE .....	1
2.	IMPAKTI MJEDISOR I PLANIT PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE 2017 – 2021 NË BASHKINË LEZHË .....	2
3.	STRUKTURA ADMINISTRATIVE .....	3
3.1.	PALËT E PËRFSHIRA, ROLI DHE PËRGJEGJËSITË.....	3
3.2.	GRUPI I PUNËS .....	4
4.	BAZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET JURIDIK TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....	5
4.1.	INSTRUMENTI JURIDIK PËR LARGIMIN E MBETJEVE.....	7
5.	VLERËSIMI I GJENDJES FILLESTARE .....	8
5.1.	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË .....	8
5.1.1.	<i>Avantazhet ekonomike.....</i>	9
5.1.2.	<i>Vlera arkeologjike dhe natyrore.....</i>	10
5.1.3.	<i>Struktura e bashkisë.....</i>	10
5.2.	PËRSHKRIMI SOCIO-EKONOMIK.....	12
5.3.	SITUATA AKTUALE E MENAXHIMIT TË MBETJEVE URBANE.....	13
5.3.1.	<i>Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve .....</i>	13
5.3.2.	<i>Mjedisi.....</i>	14
5.3.3.	<i>Çështje financiare.....</i>	16
5.3.4.	<i>Mjetet.....</i>	18
5.4.	PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE NGA VLERËSIMI I GJENDJES FILLESTARE .....	19
6.	NEVOJAT DHE PRIORITETET .....	19
7.	QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE REZULTATET .....	20
7.1.	OBJEKTIVAT E PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NË BASHKINË LEZHË.....	20
7.2.	REZULTATET DHE TREGUESIT.....	24

8.	PLANI OPERATIV I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE .....	28
8.1.	PLANIFIKIMI TEKNIK I MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....	31
8.2.	SISTEMI I MBLEDHJES DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE.....	42
8.3.	MENAXHIMI I REDUKTIMIT TË MBETJEVE .....	43
	8.3.1. <i>Versionet e përkohshme të reduktimit të mbetjeve.....</i>	43
	8.3.2. <i>Versioni i qëndrueshëm i reduktimit të mbetjeve .....</i>	45
9.	PLANI FINANCIAR I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE.....	49
9.1.	KOSTO E SHËRBIMIT 2017-2021 .....	49
	9.1.1. <i>Kosto operative të shërbimit.....</i>	50
	9.1.2. <i>Kosto kapitale.....</i>	51
	9.1.3. <i>Kosto shërbimi për njësi .....</i>	52
9.2.	PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE .....	53
9.3.	BILANCI FINANCIAR.....	56
	9.3.1. <i>Shpenzime mbështetëse.....</i>	56
10.	PLANI I VEPRIMEVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE 2017-2021 .....	58
11.	PLANI I INFORMIMIT DHE I KOMUNIKIMIT .....	72
12.	SISTEMI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.....	75
	12.1. ORGANIZIMI I EKIPIT TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT .....	76
ANEKS 1: HARTA E SISTEMIT TË TRANSPORTIT DHE PGM TË MBETJEVE.....		78
	ZONA I-RË E SHËRBIMIT .....	78
	ZONA E II-TË E SHËRBIMIT .....	88
	ZONA E III-TË E SHËRBIMIT .....	93
BIBLIOGRAFIA.....		98

## Lista e tabelave

<i>Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative në Bashkinë Lezhë.....</i>	<i>12</i>
<i>Tabela 2: Të dhëna të përgjithshme të Bashkisë Lezhë. ....</i>	<i>12</i>
<i>Tabela 4: Të dhëna mbi mbulimin aktual me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.....</i>	<i>13</i>
<i>Tabela 5: Të dhëna mbi shpeshësinë e largimit të mbetjeve.....</i>	<i>14</i>
<i>Tabela 6: Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbetjeve.....</i>	<i>15</i>
<i>Tabela 7: Të dhëna financiare për menaxhimin e mbetjeve.....</i>	<i>17</i>
<i>Tabela 8: Të dhëna mbi kostot dhe buxhetin e bashkisë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. ....</i>	<i>18</i>
<i>Tabela 9: Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.....</i>	<i>18</i>
<i>Tabela 10: Objektivi 1 i ofrimit të shërbimit. ....</i>	<i>25</i>
<i>Tabela 11: Objektivi 2 i ofrimit të shërbimit. ....</i>	<i>25</i>
<i>Tabela 12: Objektivi 3 i ofrimit të shërbimit. ....</i>	<i>26</i>
<i>Tabela 13: Objektivi 4 i ofrimit të shërbimit. ....</i>	<i>27</i>
<i>Tabela 14: Objektivi 5 i ofrimit të shërbimit. ....</i>	<i>28</i>
<i>Tabela 15: Projektioni i popullsisë në Bashkinë Lezhë 2017- 2021.....</i>	<i>28</i>
<i>Tabela 16: Gjenerimi, struktura në % (përbërja) e mbetjeve sipas studimit të Institutit të Kërkimeve Urbane në Lezhë dhe Shëngjin (2013).....</i>	<i>29</i>
<i>Tabela 17: Projektioni i gjenerimit të mbetjeve 2017 – 2021.....</i>	<i>30</i>
<i>Tabela 18: Projektioni i mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë sipas zonave të shërbimit 2017 - 2021. ....</i>	<i>31</i>
<i>Tabela 19: Projektioni i mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë 2017 - 2021.....</i>	<i>32</i>
<i>Tabela 20: Projektioni i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, si dhe i mbetjeve që nuk mbledhen në ton/vit, (2015) 2017 – 2021.....</i>	<i>33</i>
<i>Tabela 21: Projektioni i grumbullimit të mbeturinave në gjithë bashkinë 2017 - 2021.....</i>	<i>34</i>
<i>Tabela 22: Frekuenca e shërbimit gjatë Sezonit Turistik për grumbullimin e mbetjeve të pariciklueshme.....</i>	<i>37</i>
<i>Tabela 23: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të pariciklueshme Jashtë Sezonit Turistik.....</i>	<i>38</i>
<i>Tabela 24: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme gjatë Sezonit Turistik në Lezhë qytet.....</i>	<i>38</i>
<i>Tabela 25: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme gjatë Sezonit Turistik në Shëngjin qytet.....</i>	<i>38</i>
<i>Tabela 26: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme Jashtë Sezonit Turistik në Lezhë dhe Shëngjin qytet.....</i>	<i>38</i>
<i>Tabela 27: Nr. i PGM dhe Nr. i kontenierëve në sistemin e grumbullimit të diferencuar.....</i>	<i>39</i>
<i>Tabela 28: Nr. i PGM dhe Nr. i kontenierëve në sistemin e grumbullimit të diferencuar.....</i>	<i>40</i>
<i>Tabela 29: Ndarja e kontenierëve dhe pikave të grumbullimit sipas zonave të shërbimit. ....</i>	<i>40</i>
<i>Tabela 30: Rezultati i riciklimit për Zonën e I-rë. ....</i>	<i>40</i>
<i>Tabela 31: Rezultati i riciklimit për Zonën e II-të. ....</i>	<i>41</i>
<i>Tabela 32: Rezultati i riciklimit për Zonën e III-të. ....</i>	<i>41</i>
<i>Tabela 33: Rezultati i përgjithshëm i riciklimit për bashkinë Lezhë. ....</i>	<i>41</i>
<i>Tabela 34: Sasia e rikuperuar e mbetjeve sipas llojit.....</i>	<i>42</i>
<i>Tabela 35: Tabela e shpenzimeve operative.....</i>	<i>50</i>
<i>Tabela 36: Tabela e qendrave të kostos. ....</i>	<i>50</i>
<i>Tabela 37: Tabela e kostove të makinave.....</i>	<i>51</i>
<i>Tabela 38: Tabela e kostos se kontenierëve.....</i>	<i>52</i>
<i>Tabela 39: Tabela e mbulimit të kostos.....</i>	<i>56</i>

## Lista e grafikëve

<i>Grafiku 1: Grafiku mbi gjendjen e mbledhjes së tarifës së menaxhimit të mbetjeve sipas kategorive.....</i>	<i>17</i>
<i>Grafiku 2: Projektioni i popullsisë 2017 – 2021, Bashkia Lezhë.....</i>	<i>29</i>
<i>Grafiku 3: Projektioni i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë.....</i>	<i>31</i>
<i>Grafiku 4: Rritja e mbulimit me shërbim sipas Zonave të Shërbimit, 2017 - 2021.....</i>	<i>32</i>
<i>Grafiku 5: Rritja e mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë, 2016 - 2020.....</i>	<i>33</i>
<i>Grafiku 6: Projektioni i mbetjeve të pa menaxhuara.....</i>	<i>34</i>
<i>Grafiku 7: Projektioni i raportit të mbetjeve që gjenerohen dhe që nuk mblidhen në bashkinë Lezhë, 2017 – 2021..</i>	<i>35</i>
<i>Grafiku 8: Grafiku Projektioni i mbetjeve që riciklohen në raport me mbetjet që gjenerohen, 2017- 2021.....</i>	<i>41</i>
<i>Grafiku 9: Kosto totale të shërbimi.....</i>	<i>52</i>
<i>Grafiku 10: Kosto totale shërbimi për banore. ....</i>	<i>53</i>
<i>Grafiku 11: Grafiku i tarifës vjetore e shërbimit .....</i>	<i>55</i>



## 1. Hyrje

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve (PMIM) Urbane për Bashkinë Lezhe është hartuar në përputhje me qëllimet dhe afatet që parashikohen nga ligjet sektoriale të vendit, përfshirë Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Gjithashtu, përgatitja e këtij plani është në përputhje me afatin e rishikimit të planit pararendës të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Lezhë duke futur këtu dhe ndryshimet territoriale që vijnë si pasoje e Ndarjes së re Administrativo-Territoriale. Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve<sup>1</sup> i cili është aprovuar nga Parlamenti në fund të nëntorit 2011, adapton plotësisht direktivat e BE-së (75/442/EEC), si dhe përcakton njëherazi hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, duke ngarkuar me përgjegjësi bashkitë për të hartuar, miratuar dhe zbatuar Planin Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Ky plan përcakton mënyrën sipas së cilës do të ushtrohet dhe shtrihet funksioni i menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë. PMIM ofron zgjidhje lokale gjerësisht të pranuar dhe një kuadër të miratuar pune, sipas të cilit mund të merren vendime lidhur me infrastrukturën që nevojitet për të përmbushur zbatimin e praktikave më të mira mjedisore. Plani nxit një pjesëmarrje më të mirë të gjitha palëve dhe paraqet një këndvështrim strategjik të menaxhimit të mbetjeve, duke e vënë theksin në zgjerimin e zonës së shërbimit, në sasinë në rritje të mbetjeve dhe lehtësirat e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve.

Gjithashtu, plani përfshin:

- Vlerësim të gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Qëllimin dhe objektivat për shërbim cilësor të menaxhimit të mbetjeve;
- Sistemi i matjes së performancës;
- Një plan të detajuar teknik dhe financiar për menaxhimin e integruar të mbetjeve; dhe,
- Protokollin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V)

Ky plan është ideuar në përputhje me manualin për planifikimin e shërbimit të largimit të mbetjeve bashkiake të *DLDP* (Planning Local Waste Management, 2012).

Gjithashtu llogaritja e kostove të këtij plani janë bere në përputhje me manualin e llogaritjes së kostos të hartuar nga *DLDP* "Manuali i llogaritjes së kostove për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në nivel lokal në Shqipëri" - titulli origjinal (CALCULATING THE COST FOR SOLID WASTE MANAGEMENT AT LOCAL GOVERNMENT UNIT LEVEL IN ALBANIA, 2013)

---

<sup>1</sup> (Ligji Nr. 10 463, 2011) "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve i ndryshuar"

## 2. Impakti Mjedisor i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2017 – 2021 në Bashkinë Lezhë

Zbatimi i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme impaktin mjedisor nga mbetjet në të gjithë territorin e bashkisë nëpërmjet:

- Zvogëlimit maksimalisht të hedhjes së mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar në natyrë dhe veçanërisht në rrjedhat ujore sipërfaqësore;
- Rikuperimin e burimeve të vlefshme nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit dhe reduktimin e mbetjeve që depozitohen përfundimisht në venddepozitim;
- Mbrojtjen e vendbanimeve, zonave turistike dhe ekosistemeve nga depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve në natyrë.

Si rrjedhojë, kontrolli mbi grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar do të kontribuojnë në zvogëlimin e gazeve serë që gjenerohen nga mbetjet.

Në mënyrë të veçantë menaxhimi i integruar i mbetjeve në bashkinë Lezhë do të ndikojë në:

- **Cilësinë e Ujërave Sipërfaqësorë:** shtrirja e mbulimit me grumbullimin e mbetjeve nëpërmjet sistemit të kontenierëve të kombinuar me qese në të paktën 95% të territorit të bashkisë do të minimizojë impaktin negativ të lëngjeve të ndotura që gjerohen nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve përgjatë rrjedhave ujore.
- **Flora, Fauna dhe Biodiversiteti:** Në territorin e bashkisë së Lezhës ndodhen zona / habitatet ujore me ndjeshmëri të lartë si laguna Kune - Vain – Tale, lumi, Drin dhe vija bregdetare. Eliminimi i hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve në këto zona do të përmirësojë kushtet e jetesës dhe do të mundësojë ruajtjen e vlerave natyrore të faunës, florës dhe biodiversitetit në këto habitate.
- **Peizazhi dhe aspekti vizual:** Çështja kryesore lidhur me këtë aspekt do të jetë aspekti vizual që japin pastërtia nga mbetjet dhe veçanërisht eliminimi i grumbullimeve të pakontrolluara të mbetjeve. Standardi i shërbimit, shpërndarja dhe cilësia e kontenierëve, do të krijojnë mundësinë e eliminimit të vend depozitimeve të pakontrolluar, rrjedhimisht do të përmirësojnë peizazhin dhe aspektin vizual nga mbetjet e shpërndara në territor.
- **Ekonomia dhe jetesa:** Baza e ekonomisë dhe jetesa sigurohen nga turizmi, atraksioni i burimeve natyrore dhe ekonomia bujqësore. Lezha është kthyer në një qendër të atraksionit kulinar mbi bazën e prodhimeve bio. Këto burime rrezikohen nga administrimi irracional i mbetjeve. Kontrolli mbi grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve ashtu siç propozohen në këtë Plan, kanë për synim që të sigurojnë një mjedis të pastër dhe atraktiv i cili mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.
- **Shëndeti dhe siguria e komunitetit:** Shëndeti dhe siguria e banorëve të Lezhës mund të ndikohet nga mënyra se si grumbullohen, transportohen dhe trajtohen mbetjet. Standardi i grumbullimit dhe transportit, si dhe mjetet që kërkohen në zbatim të Planit japin siguri për ruajtjen e shëndetit, minimizimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmave.
- **Biodiversiteti në zonat e mbrojtura:** Hapësira Kune – Vain – Tale është një zonë e mbrojtur e kategorisë së IV-tët. Sistemi i menaxhimit të mbetjeve siç është planifikuar në këtë dokument, ka

marrë në konsideratë në mënyrë të veçantë ruajtjen e biodiversitetit dhe të habitateve në këtë zonë. Megjithëse tregohet kujdes, në këto zona Plani do të sigurojë grumbullimin e rregullt dhe të kontrolluar të mbetjeve, me fokus eliminimin e vend depozitimeve të paligjshme të cilat mund të cenojnë sigurinë dhe kushtet diverse të ekosistemit të këtij habitati.

***Në lidhje më ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e impaktit negativ që mund të shkaktohet nga keq menaxhimi i mbetjeve, është e nevojshme që të ndërtohet një Objekt për Reduktimin e Mbetjeve cili do të shërbejë për të adresuar disa prej rreziqeve ndaj mjedisit në territorin e bashkisë. Ndërtimi i këtij objekti duhet të paraprihet nga një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis i cili duhet të plotësojë kërkesat e legjislacionit Shqiptar si dhe standardet ndërkombëtare të njohura përgjithësisht dhe Konventat ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.***

### 3. Struktura administrative

#### 3.1. Palët e përfshira, roli dhe përgjegjësitë

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane është një përgjegjësi e ndare midis disa palesh siç janë, familjet, bizneset, zyra dhe institucione mbetjet e të cilëve janë të ngjashme me ato të gjeneruara në ambientet e shtëpive. Palët e përfshira dhe përfituesit direkt në këtë proces janë njësitë familjare, komuniteti i biznesit, komuniteti i mbledhësve informal të mbetjeve të riciklueshme dhe autoritetet vendore e qendrore në Lezhë. Performanca e çdo pale në këtë proces do të ndikojë në rezultate pozitive për afrimin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve i cili do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të cilat përfundojnë në depozitimin final, rrjedhimisht dhe në uljen e kostove të transportit.

Për këtë arsye njësitë familjare, bizneset dhe institucione dhe të gjitha palët e tjera inkurajohen të marrin mbi vete përgjegjësitë të cilat vijnë me gjenerimin e mbetjeve në mënyrë për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin e përbashkët. Përgjegjësitë e të gjithë palëve dhe përfituesëve midis të tjerave përfshijnë:

- Reduktimin në masën me të madhe të mundshme të gjenerimit të mbetjeve;
- Ndarjen në burim të mbetjeve të njoma (biodegradueshme) nga ato të thata (riciklueshme);
- Bashkëpunimi me autoritetet vendore duke i hedhur mbetjet në kontenierët e duhur sipas instruksioneve të marra nga autoritetet përkatëse, duke respektuar kohën dhe vendin, si dhe duke paguar tarifën e shërbimit;

Megjithatë përgjegjësia e përfituesëve është gjithsesi e limituar deri në momentin e hedhjes së mbetjeve në pikat e grumbullimit të mbetjeve (PGM) të cilat menaxhohen nga kompania e menaxhimit të shërbimit. Kjo e fundit ka përgjegjësinë e parandalimit të shpërndarjes së mbetjeve dhe të depozitimit të tyre në një pikë të autorizuar të depozitimit/trajtimit të mbetjeve. Në këtë kontekst bashkia është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e gjithë sistemit të mbledhjes nga PGM-të deri tek pika e autorizuar e depozitimit/trajtimit të mbetjeve. Autoritetet vendore janë të detyruara që sipas Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve<sup>2</sup> të sigurojnë menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në mënyrën me të mire. Gjithashtu është e rëndësishme që bashkia të krijojë një bazë të dhënash të qartë të të dhënave mbi popullsinë<sup>3</sup>, bizneset, gjenerimin e mbetjeve dhe llojin e tyre duke i

<sup>2</sup> (Ligji Nr. 10 463, 2011) "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

<sup>3</sup> Numri i popullsisë, banesave, përbërjen e familjeve, nivelin ekonomik.

përfshirë këto në një proces të plotë auditimi në mënyrë që të bëhet optimizimi i plotë i shërbimit të largimit të mbetjeve.

Nga ana tjetër, komuniteti i mbledhësve informal të mbetjeve të riciklueshme ka një rol të rëndësishëm në procesin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë. Të organizuar në grupe ose në mënyrë individuale, mbledhësit e mbetjeve të riciklueshme ushtrojnë aktivitetin në qytet (nëpër kontenerë) si dhe në vend depozitimet ilegale të mbetjeve. Megjithatë mungojnë të dhëna zyrtare mbi numrin e personave që grumbullojnë mbetje të riciklueshme apo mbi volumin e mbetjeve që grumbullohen në qendrat e grumbullimit.

Për këtë arsye propozohet gjithashtu që Qeveria Qendrore (QQ) të bashkëpunojë me bashkinë në mënyrë që të reformojnë kuadrin aktual të grumbullimit të mbetjeve dhe të konsiderojnë zgjidhje të tilla si rajonizimi nëpërmjet stacioneve të transferimit duke paraprirë depozitim në destinacionin final të Bushatit. Gjithashtu do të punohet në zgjidhjen njëres nga sfidat kryesore të planit e cila do të jetë përcaktimi i rolit të mbledhësve informal në sistemin e integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Lezhë.

### 3.2. Grupi i punës

Grupi i Punës për Hartimin e PMIM-së është rezultat i analizës se palëve të interesit të cilët marrin pjesë ose ndikojnë në realizimin e shërbimit të largimit dhe përpunimit të mbetjeve të ngurta urbane nga qyteti i Lezhës.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë u ngrit Grupi i Punës (GP) nga ana e bashkisë për zbatimin e projektit për asistencën në Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Urbane. GP përbëhet nga nëpunës të Bashkisë Lezhë dhe nga stafi i projektit. Ky grup, i drejtuar nga kryetari i Bashkisë, pati përgjegjësinë për t'u këshilluar me autoritetet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar zbatueshmërisë me efektivitet dhe eficiencës të planit, si dhe koordinimin e çështjeve të menaxhimit të mbetjeve me politikat kombëtare.

Grupi i Punës i angazhuar për hartimin e Planit përbehet nga:

Kryetari Grupit	Enver Hafizi	Zv/kryetar i bashkisë
Anëtarë	Petrit Marku	Drejtori, Drejtoria e Programimit
	Tonine Marku	Drejtores, Drejtoria Menaxhimit Financiar
	Ndue Lusha	Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve
	Ernest Marku	Inspektor
	Indrit Torbaj	Inspektor
	Evaristo Coli	Inxh. IT, Drejtoria e Programimit
	Xhovalin Kola	Urbanist, Drejtoria e Programimit
	Flora Dedgjonaj	Përgjegjëse e Sek. Prokurimeve, Drejtoria Juridike
	Bukurie Molla	Sektori i Prokurimeve, Drejtoria Juridike

Grupi i Punës në bashkinë Lezhë është asistuar intensivisht nga specialistet e Institutit të Kërkimeve Urbane Edlir Vokopola, Dritan Gorica dhe Entela Kallamata. PMIM është hartuar me financimin e DLDP dhe mbështetjen e drejtuesve të këtij projekti Znj. Valbona Karakaçi, z. Arben Koplaku si dhe ekspertizën e organizatës zvicerane Helveta Swiss Cooperation Felix Schmidt dhe Emilie Gex.

Grupi i Punës është mbledhur në seanca të veçanta për të analizuar gjëndjen e shërbimit mbas zbatimit të Reformës Administrativo Territoriale, hartimin e politikave të bashkisë të tilla për të synuar përputhjen e planit me kërkesat ligjore dhe objektivat kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, aspektet financiare dhe ato juridike. Grupi i Punës ka diskutuar dhe ka pranuar standardin e shërbimit dhe kostot respektive siç janë parashtruar në këtë Plan.

GP është i vetëdijshëm se disa prej kostove nëpërmjet të cilave do të bëhet e mundur që të arrihen objektivat maksimale të Planit, nuk është e mundur që të realizohen nga buxheti i bashkisë, për rrjedhojë përgatitja e projekteve dhe identifikimi i burimeve të tjera financiare mbetet një objektivi i rëndësishëm për bashkinë në vitet që do të vijnë.

#### 4. Baza ligjore dhe instrumentet juridik të menaxhimit të mbetjeve

Pavarësisht cilësisë dhe problemeve që lidhen me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri, kuadri ligjor ka përparuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve ka qenë vazhdimisht në përmirësimin, dhe gjatë dhjetë viteve të fundit, ligjet e shumta, dekretet dhe udhëzimet që janë miratuar janë përshtatur me Direktivat e BE-së dhe kërkesat e Konventës së Bazelit.

##### ***Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta***

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, nr. 10 463, datë 22.09.2011, i ndryshuar, është aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të shtatorit 2011.

Ligji adapton plotësisht shumicën e direktivave dhe rregulloret e BE-së, dhe siguron bazën e duhur ligjore për përshtatjen e plotë të gjithë legjislacionit të BE-së në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

##### ***Përgjegjësia për Menaxhimin e Mbetjeve***

Neni 10 i Ligjit parashikon se Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratohet në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të Planeve Rajonale dhe Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve.

Neni 15 parashikon se Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të krijohet në nivel kombëtar, dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve në shkallë kombëtare.

Neni 20 përcakton se shpenzimet për menaxhimin e integruar të mbetjeve mbulohen bazuar në parimin "ndotësi paguan", përveç rastit kur Këshilli i Ministrave apo këshillat vendore vendosin që pjesë të koston apo gjithë kosto mbulohen nga te tjerë që nuk janë gjeneruesit fillestare të mbetjeve .

Për më tepër i njëjti ligj parashikon ndarjen e autoritetit, funksionet, rolet dhe përgjegjësitë, nga lartë - poshtë, nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore. Në veçanti, ligji ngarkon njësitë e qeverisjes vendore me sa më poshtë:

- i. Të miratojë një plan të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Qarkut,
- ii. Të miratojë rregullat e kontrollit të menaxhimit të mbetjeve të veçanta, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, ushqim dhe kontejnerëve të pijeve, metalin, plastikën apo mbetjet e oborrit,

- iii. Të raportojë çdo vit në qarkun përkatës dhe institucione të tjera për zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve vendore,
- iv. Të publikojë një draft të Planit dhe ta vere atë në dispozicion të publikut përmes faqes së internetit të qeverisjes vendore,
- v. Të miratojë Planin përkatës duke marrë në konsideratë rezultatet e çdo Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), përpara miratimit të saj.

### ***Strategjia dhe Plani Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve***

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale e Mjedisit për 2013 - 2020 (Strategjia) përcakton politikat e menaxhimit të programit të mbetjeve, që synojnë zhvillimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit sipas direktivave të BE-së, zbatimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe lokale.

Sfidat kryesore që do të adresohen, siç është përcaktuar nga strategjia përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, si vijon:

- i. Krijimi i një sistemi funksional të integruar të menaxhimit mbetjeve,
- ii. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit mbi menaxhimin e mbetjeve,
- iii. Bashkëpunimi administrativ mes autoriteteve të ndryshme kombëtare dhe vendore, ndarja e përgjegjësisë në zbatimin e legjislacionit përkatës.

Brenda harkut kohor të zbatimit, strategjia synon arritjen e objektivave të mëposhtme:

- i. Ulja me 45% e mbetjeve që janë depozituar në depozita / landfill-e
- ii. Riciklimit deri në 55% të mbeturinave bashkiake, dhe
- iii. Hartimi i planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve dhe zhvillimin e landfill-eve rajonale

Objektivat e Strategjisë në afatgjatë (2015 - 2020), përfshijnë ndërtimin e landfill-eve në të gjitha qarqet dhe mbyllja e landfilleve bashkiake në mbarë vendin me financimin e buxhetit të shtetit, si dhe krijimi i sistemeve të grumbullimit të ndarë që do të çojnë drejt një reduktim deri në 45% të mbetjeve të depozituara në landfill dhe riciklimin deri në 55% të totalit të mbetjeve bashkiake.

### **VKM Nr. 418, datë 25.06.2014, “ Për Grumbullimit e Diferencuar të Mbetjeve në Burim”**

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i afateve dhe masave për grumbullimin e diferencuar të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

- a) Optimizmit të grumbullimit të mbetjeve;
- b) Sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
- c) Promovimit të ripërdorimit të produkteve;
- d) Përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
- e) Përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

Ky Vendim përcakton objektivin për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, njëherazi dhe vizionin e menaxhimit të mbetjeve deri në vitin 2020. Sipas këtij Vendimi:

- Bashkitë qendër qarku përcaktojnë masat e përshtatshme për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në tre rryma brenda datës 31 Dhjetor 2016”;
- “Objektivi për t’u arritur nga njësitë e qeverisjes vendore brenda datës 31 Dhjetori 2020, për përgatitjen, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta, ku përfshihen letra, metali, plastika dhe qelqi duhet të arrijnë minimumi në 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014”.

### Standardet e Komunitetit Evropian

Kuadri i direktivës së mbetjeve është legjislacioni gjithëpërfshirës nga Bashkimi Evropian që kanë të bëjnë me mbetjet. Direktiva 2008/98/EC mbi mbetjet e miratuar në nëntor 2008 parasheh një qasje të re të menaxhimit të mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe menaxhimit për ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, dhe synon kufizimin e prodhimit të mbetjeve si dhe inkurajon përdorimin e mbetjeve si burim përmes riciklimit dhe rikuperimit. Në mënyrë për të arritur këtë qëllim, Direktiva Evropiane ka vendosur si prioritet hierarkinë në vijim për menaxhimin të mbetjeve:

- i. Parandalim
- ii. Përgatitja për ripërdorim
- iii. Riciklimit
- iv. Rikuperime të tjera, p.sh. burim energjie
- v. Asgjësimi

Gjithsesi, për kushtet e Shqipërisë, grumbullimi i mbetjeve është një parakusht, për të vijuar më tej me zbatimin e hierarkisë prioritare sipas Direktivave të BE.

#### 4.1. Instrumenti juridik për largimin e mbetjeve

Propozimi për zgjedhjen e instrumentit ligjor për menaxhimin e shërbimit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve bazohet mbi aktet ligjore si më poshtë e të tjera dhe në vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë.

- 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.8094, datë 21.3.1996, “Për largimin Publik të Mbeturave”; dhe
- Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publiko privat”;
- VKM Nr. 418 datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- VKM Nr. 608, datë 17.09.2014, “Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;
- Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

Zbatimi i këtij Plani është konsideruar të realizohet më sipërmarrje private, e kontraktuar nga bashkia për një periudhë 1-5 vjeçare. Sipërmarrësi privat ose operatori ekonomik privat do të zgjidhet me procedurën e tenderit të hapur në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, “Për largimin Publik të Mbeturinave”.

Sipërmarrësi privat do të respektojë të gjitha specifikimet teknike të cilat bazohen mbi kërkesat e nenit 23 “kushtet e garës” të ligjit Nr.8094, datë 21.3.1996, “Për largimin Publik të Mbeturinave”.

Kjo kontratë lidhet pas zbatimit të një procedure prokurimi mbi bazën e fondeve që janë përcaktuar në buxhetin e bashkisë me vendimin e Këshillit Bashkiak. Kontrata lidhet për një afat jo më shumë se 5 vjeçar. Neni 20 i ligjit Nr.8094, si më sipër.

Për kontrata me afat më të gjatë, bashkia duhet ti referohet dhe të zbatojë dispozitat e ligjit nr. 125/2013 Ndryshuar me Ligjin Nr.88/2014, “Për koncesionet dhe partneritetin publiko – privat; i ndryshuar.

Kontrata me sipërmarrësin/operatorin privat do të përfshijë aktivitete si më poshtë:

- Grumbullimin, fshirjen e territorit të pikës së grumbullimit, dezinfektimin, larjen e kontenerëve;
- Transportin e mbetjeve në vendgrumbullim;
- Grumbullimin e diferencuar, transportin e mbetjeve të riciklueshme ne vendgrumbullim, selektimin dhe tregtimin e mbetjeve të riciklueshme;
- Grumbullimin e diferencuar, transportin e mbetjeve të ricikluesme të njoma (bio). Ngritjen, organizmin dhe funksionimin e njësisë së kompostimit ne venddepozitim dhe tregtimin e produktit nga kompostimi;
- Depozitimin e mbetjeve për trajtimin përfundimtar në në vendgrumbullim.

## 5. Vlerësimi i gjendjes fillestare

### 5.1. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë

Bashkia Lezhë përbëhet nga 10 njësi administrative (Nj.A). Qendra urbane e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës dhe ish-komunat Shënkoll, Shëngjin, Balldren, Blinisht, Dajç, Ungrej, Kolç dhe Zejmen janë NJA-të përbërëse te saj.






Figura 1: Pozicioni gjeografik dhe NJA-të e bashkisë Lezhë

Ky bashkim vjen si rezultat i ndarjes së re administrative-territoriale e cila u miratuar në vitin 2014 (Ligj nr. 115/2014 datë 31.07.2014) “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe hyri në fuqi në vitin 2015 pas zgjedhjeve lokale. Në figurën me sipër tregohet shtrirja aktuale e Bashkisë Lezhë.

Njësitë administrative ndodhen në distancë të favorshme që mundëson akses të lehtë me qendrën urbane të kësaj bashkie. Me përjashtim të komunës Ungrej, e cila gjendet rreth 20 km larg dhe e cila ka edhe kohën më të gjatë të udhëtimit (82 minuta), të gjitha NJA-të e tjera, të ndihmuara dhe nga infrastruktura rrugore, mund të arrijnë në qendrën e bashkisë për 10-20 minuta.

#### 5.1.1. Avantazhet ekonomike

Bashkia Lezhë ka një pozicion gjeografik shumë të favorshëm për bizneset dhe investimet, duke qenë se është një lidhëse në rrjetin kombëtar dhe rajonal të transportit:

**Porti i Shëngjinit.** Ndodhet vetëm 6 km nga qendra e bashkisë dhe është pjesë e një masterplani afat gjatë për zhvillimin e harmonizuar drejt ekonomisë së tregut. Aktualisht, në këtë port ankorohen anije transporti mallrash dhe trageti i linjës Bari-Shëngjin. Porti i Shëngjinit shihet si pikë lidhëse që lidh gjithë Veriun e Shqipërisë dhe Kosovën me rrugë detare me shtete të tjera.

**Transporti.** Rruga Lezhë-Tiranë, 55 km nga Kryeqyteti i Shqipërisë, shihet si shtylla kurrizore e një korridorit ekonomik. Distanca prej 35 km nga aeroporti Kombëtar i Rinasit, 35 km nga Shkodra dhe 45 km nga kufiri me Malin e Zi, korridori Lezhë-Shkodër-Mal i Zi, shihet nga studiuesit se do të funksionojë me dinamikë në të ardhmen dhe se Lezha do të forcohet si qytet kufitar me veriun e Shqipërisë.

**Turizmi.** Bashkia e Lezhës ka një vijë bregdetare rreth 30 km të gjatë përfshirë lagunën Kune – Vain – Tale dhe Shëngjinin, një vend eko-turistik i rëndësishëm në Detin Adriatik, që njihet për plazhet e bukura të karakterizuara nga pastërtia e detit, qetësia dhe ajri i pastër. Plazhi i Shëngjinit është një ndër plazhet më të rrahura, si nga pushuesit vendas ashtu dhe të huaj. Fluksi ditor i pushuesve gjatë stinës së verës varion nga 20.000 (në ditë të zakonshme) deri në 50.000 (në fundjavë).

### 5.1.2. Vlera arkeologjike dhe natyrore

Në juridiksionin territorial të Bashkisë së Lezhës ka burime të ndryshme kulturore, disa prej të cilave kanë një status të veçantë historik dhe arkeologjik, siç është Kështjella e Lezhës dhe varri i Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

*Burimet natyrore dhe kulturore të qytetit dhe rajonit e bëjnë këtë zonë mjaft tërheqëse dhe një ndër burimet turistike më të rëndësishme të vendit, zhvillimi i të cilave kërkon një ristrukturim të sistemit të menaxhimit të mbetjeve bashkiake në një nivel më të lartë të cilësisë së shërbimit.*

### 5.1.3. Struktura e bashkisë

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 148 dt. 06.06.2016 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Lezhë për vitin 2016” Numri i punonjësve gjithsej si bashki për vitin 2016 do të jetë 755 vetë.

- Punonjës të administratës së bashkisë 156 persona, nga këto:
  - Punonjës të policisë bashkiake 14 persona
  - Punonjës të njësive administrative 148 persona
  - Punonjës të institucioneve varëse 50 persona
  - Punonjës të Agjencive 120 persona
  - Punonjës me kontratë 6 mujore 50 punonjës
- Punonjës që paguhen nga Transferta Specifike 243 persona

Këshilli i bashkisë Lezhë është i përbërë nga 41 anëtarë nga të cilët 11 janë gra. Në varësisë të Bashkisë Lezhë janë një sere institucionesh të tjera siç janë biblioteka, pallati i kulturës, muzeu-memoriali i Skënderbeut etj. Organigrama e Bashkisë Lezhë në zbatim të Vendimit të Bashkisë të cituar më sipër është paraqitur në figurën me poshtë.

Përsa i përket menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane Drejtoria e Shërbimeve Publike është departamenti kryesor që kujdeset për mbarëvajtjen e këtij shërbimi. Drejtoria e Shërbimeve Publike ka si objektive dhe punon në realizimin e shërbimeve publike për komunitetin dhe t’i përmirësojë ato vazhdimisht duke programuar, planifikuar, monitoruar dhe realizuar këto objektiva në interes të komunitetit qytetar, të ndërtojë strategjitë për programimin, planifikimin dhe implementimin e investimeve në veprat publike, të harmonizojë gjithë veprimtarinë e enteve të ndryshme, veprimtaria e të cilave ka të bëjë direkt ose indirekt me shërbimet dhe veprat publike të Lezhës midis tyre dhe shërbimin e largimit të mbetjeve të ngurta urbane.




Figura 2: Organigrama e bashkisë Lezhë.

## 5.2. Përshkrimi Socio-Ekonomik

Sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011 popullsia rezidente e bashkisë është 65, 633 banorë. Ndërkohë, të dhënat zyrtare të Regjistrit të Gjendjes Civile (RrGjC), të mbledhura gjate auditit të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane, të vitit 2015 flasin për numër popullsie të regjistruar rreth 40% më të lartë.

Njësitë Përbërëse	Popullsia Census 2011	Popullsia Regjistri Civil 2015	Popullsia rezident efektive <sup>4</sup>	Sip Km <sup>2</sup>	Dendësia Banore	Distanca nga qendra e Bashkisë	Koha e udhëtimit nga qendra e Bashkisë (min.)
Ungrej	1,587	3,200	2,240	118	19	20	82
Blinisht	3,361	5,486	3,840	48	80	10	16
Dajç	3,834	7,078	4,955	35	142	15	18
Kallmet	4,118	7,000	4,900	38	129	6	13
Kolsh	4,228	6,022	4,215	45	94	2	10
Zejmen	5,660	9,629	6,740	35	193	8	13
Balldren	6,142	10,936	7,655	77	99	5	10
Shëngjin	8,091	12,000	8,400	56	150	7	9
Shënkoll*	13,102	16,700	11,690	40	292	10	14
Lezhë	5,510	30,127	21,089	5	4,218	-	-
Total Bashkia	65,633	108,178	75,725	497	152		

Tabela 1: Shpërndarja e popullsisë sipas njësive administrative në Bashkinë Lezhë.

Bazuar në të dhënat e Census-it të vitit 2011, në bashkinë e Lezhës niveli i urbanizimit është tepër i lartë. Dendësia<sup>5</sup> në Bashkinë Lezhe është 152 banorë/km<sup>2</sup>, duke ulur kështu diferencimin tejet të lartë të dendësisë (asaj minimale dhe maksimale) të popullsisë ndërmjet zonave rurale të kësaj njësie.

Të dhëna	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Kolsh	Ungrej	Bashkia Lezhë
<b>Familje</b>	8,500	3,335	2,956	1,600	2,406	4,620	1,872	1,513	1,628	865	<b>29,295</b>
<b>Biznese të vogla</b>	670	250	90	49	66	129	50	40	60	na	<b>1,404</b>
<b>Bizneseve të mëdha</b>	230	80		6	32	21			2	na	<b>371</b>
<b>Institucione</b>	35	10	8	13	8	15	15	15	na	15	<b>134</b>
<b>Ndërtesa</b>	na	na	na	1,400	na	3,800	1,500	1,401	na	na	<b>8,101</b>
<b>Veprimtari turistike</b>	Po	Po	na	Po	na	Po	na	Po	na	Jo	<b>Po</b>
<b>Turistë (vit)</b>	5,000	600,000	1,000	5,000	na	5,000	na	3,000	na	100	<b>619,100</b>

Tabela 2: Të dhëna të përgjithshme të Bashkisë Lezhë.

Numri i popullsisë gjithsej në bashkinë Lezhë sipas Gjendjes Civile 2015 është 108,178 banorë ndërsa numri i përafërt i familjeve është 29,612. Numri i familjeve për njësitë administrative Balldre, Kolsh dhe Ungrej, për të cilat të dhënat e sakta mungojnë, është përlogaritur me raportin mesatar popullsi-familje të njësive të tjera administrative.

<sup>4</sup> Banorë rezidentë efektive = [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census)\*30%] (Ligji nr.147/2015 "Per buxhetin e vitit 2016"), Aneksi 1.

<sup>5</sup> Dendësia e banoreve për km<sup>2</sup> referuar popullsisë rezidente efektive.

Numri i bizneseve gjithsej rezulton përafërsisht 1,775, nga të cilët 371 biznese të mëdhenj dhe 1,404 të vegjël. Numri mbetet për t'u saktësuar; në njësitë Kallmet, Shënkoll e Zejmen kjo e dhënë është e përafëruar për vitin 2014 nisur nga vitet e mëparshme, ndërsa mungon krejt për njësinë Ungrej.

Bashkia Lezha ka një veprimtari turistike të konsiderueshme sidomos gjatë sezonit veror duke qenë se është e shtrirë përgjatë detit Adriatik. Ajo është e përqendruar në Shëngjin, ku numri i turistëve gjatë sezonit veror vlerësohet rreth 50,000 në çdo ditë të fundjavës. Qyteti i Lezhës dhe njësitë Kallmet e Shënkoll janë gjithashtu pika të rëndësishme turistike të cilat tërheqin rreth 5,000 vizitorë në ditë gjatë sezonit të verës. Gjithsesi mendohet se numri i turistëve në bashkinë Lezhë është më i madh se sa ai që raportohet por i pamundur për tu saktësuar dhe certifikuar.

### 5.3. Situata aktuale e menaxhimit të mbetjeve urbane

Bashkia Lezhë aktualisht ofron me sipërmarrje shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Ky shërbim kryhet nga sipërmarrës privatë në bazë të një kontrate yë lidhura nga ish-komunat - njësitë e qeverisjes vendore.

Inspektorët përgjegjës, specialistë të fushës dhe mbikëqyrësit e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, sipas organizimit të ish-njësive vendore, jepen në tabelën e mëposhtme. Të dhënat pohojnë se punonjësit e mësipërm kanë nevojë të trajnohen për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Të dhënat janë mbledhur gjithashtu dhe për numrin e punëtorëve dhe të shoferëve në këtë shërbim, të cilët përbëjnë rreth 53 punonjës dhe 9 shoferë për të gjithë Bashkinë Lezhë. Ata janë të punësuar nga shoqëritë sipërmarrëse.

#### 5.3.1. Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Grupi i dytë i të dhënave jep një pamje të përgjithshme të mbulimit të tanishëm të popullatës me shërbim të rregullt (çdo javë) të menaxhimit të mbetjeve.

Të dhëna	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Kolsh	Bashkia Lezhë
<b>PMM</b>	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Jo	Jo	
<b>Popullsia që merr shërbim</b>	29,000	9,650	4,265	2,000	5,777	7,490	6,700	4,400	na	<b>69,282</b>
<b>Familje që marrin shërbim</b>	8,259	2,727	1,153	777	1,444	2,204	1,772	1,213	na	<b>19,550</b>
<b>% e popullsisë që merr shërbim</b>	97%	82%	39%	49%	60%	48%	95%	80%	na	<b>66%</b>
<b>% e përafëruar e territorit që merr shërbim të fshirjes së rrugëve</b>	60%	20%	na	0	0	40%	0	0	0	
<b>% e përafëruar e territorit që merr shërbim të larjes së rrugëve</b>	40%	0	na	0	0	30%	0	0	0	
<b>Mbetje të mbledhura (ton/vit)</b>	8,760	5,938	2,350	402	1,200	2,000	500	350	1,150	<b>22,650</b>
<b>Mbetje të mbledhura (ton/vit) (e përafëruar)</b>	7,304	4,550	na	402	730	1,504	500	642	402	<b>16,033</b>
<b>Gjenerimi i kg/banorë/ditë</b>	0.69	1.29	na	0.55	0.35	0.55	0.40	0.40	0.40	<b>0.56</b>

Tabela 3: Të dhëna mbi mbulimin aktual me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Sipas të dhënave, në Bashkinë Lezhë afërsisht 66% e popullsisë merr shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve. Niveli më i ulët i mbulimit regjistrohen në njësinë administrative Balldre për 39% të popullatës. Njësia administrative Ungrej është e vetmja që nuk ofron shërbim të rregullt.

Vihet re se në çdo njësi administrative ka diferenca midis sasisë ton/vit të mbetjeve që mbledhen e përafuar nga vëllimi i kazanëve të shpërndarë me sasinë e mbetjeve të përcaktuar në kontratat me shoqëritë private sipërmarrëse të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Në tabelën e mëposhtme përmbledhen dhe shpeshtësia e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe të pastrimit të rrugëve: fshirje dhe larje. Duke veçuar Lezhën, diferencim të zonave urbane dhe atyre rurale ka vetëm në njësinë administrative Shëngjin.

Të dhëna	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Kolsh
<b>Shpeshtësia e mbledhjes së mbetjeve</b>	7 herë/javë	Z.urbane 7 /javë Z.rurale 1/javë	3 herë/javë	2 herë/javë	2 herë/javë	1 herë / 2 ditë	1 herë/javë	1 herë/javë	1 herë/javë
<b>Shpeshtësia e fshirjes së rrugëve</b>	7 herë/javë	2 herë /ditë				1 herë / 2 ditë			
<b>Shpeshtësia e larjes së rrugëve</b>	7 herë/javë	2 herë /ditë <b>në verë</b>				1 herë / 2 ditë			

Tabela 4: Të dhëna mbi shpeshtësinë e largimit të mbetjeve.

### 5.3.2. Mjedisi

Grupi i tretë i të dhënave përmbledh çështje të mjedisit që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbetjeve.

Të dhëna	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Kolsh
<b>Matje mbi përbërjen e mbetjeve?</b>	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
<b>Pika të hapura të grumbullimit të mbetjeve</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	20-30
<b>Vende të autorizuara të depozitimit</b>	0	na	na	na	na	na	1	1	0
<b>Vende të pa autorizuara të depozitimit</b>	0	0	0	0	Berzanë	0	0	2	0
<b>Venddepozitime që janë mbyllur</b>	1	na	na	1	1	na	0	0	na
<b>Vend i caktuar për asgjësimin e mbetjeve inerte</b>	Në zonën e kënetës	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Po	Jo	Jo
<b>% e mbetjeve që në lëndfillin Bushat</b>	80-90%	na	na	90%	na	na	100%	100%	na
<b>% e mbetjeve në venddepozitim të autorizuar</b>	0%	na	na	na	na	na	0%	0%	na
<b>% e mbetjeve në venddepozitim të pa autorizuar</b>	0%	0%	0%	0%	na	na	0%	0%	0%
<b>Sistem të diferencuar?</b>	Po	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo
<b>Sasia e mbetjeve R e mbledhur dhe e përpunuar (ton/vit)</b>	580								
<b>% e mbetjeve R të mbledhura dhe të përpunuara</b>	<b>7%</b>								
<b>A ka nisma për kompostim?</b>	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo



Tabela 5: Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

Në bazë të këtyre të dhënave në Bashkinë Lezhë:

- gjenden rreth 20-30 pika të hapura (pa kazanë) të grumbullimit të mbetjeve nga banorët në njësinë administrative Kolsh, ndërsa nuk ka një të dhënë të saktë për njësinë Ungrej;
- gjenden gjithsej 3 vende depozitimi të mbetjeve të paautorizuara, 2 me vendndodhje në Blinisht, dhe 1 në Bërzanë, Zejmen; nga ana tjetër të dhënat pohojnë se këto vend depozitime nuk përdoren më nga njësitë për shërbimin e mbetjeve, megjithatë nuk janë marrë masa për mbylljen sanitare të tyre;
- mbetjet urbane depozitohen pothuajse nga të gjitha njësitë administrative në landfill-in e Bushatit;
- ka minimalisht dy vende të caktuara për asgjësimin e mbetjeve inerte, në zonën e kënetës në Lezhë dhe në Dajç.



Figura 3: Vend depozitime ilegale në territorin e Bashkisë Lezhë.

### Riciklimi

Në qytetin e Lezhës ka ekzistuar sistemi i grumbullimit të mbetjeve me dy rryma, mbetje të pa riciklueshme dhe mbetje të riciklueshme (letër, metal, plastikë etj.). Mbetjet e riciklueshme janë grumbulluar përmes kontenierëve dhe qeseve plastike, si dhe nga mbledhësit informalë. Sistemi me dy kontenierë dhe ai me qese derë më derë kanë qenë pjesë e sistemit eksperimental të mbledhjes së mbetjeve të riciklueshme, i cili është zbatuar në qytetin e Lezhës. Ky projekt është zbatuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane dhe ka funksionuar efektivisht deri në momentin e përfundimit të programit dhe me pas ka ndaluar se funksionuari.

Gjithashtu pjesë e programit ka qenë dhe Qendra për Selektimin e Mbetjeve të Riciklueshme e cila ka funksionuar për selektimin e mbetjeve të riciklueshme të mbledhura nga procesi i grumbullimit me kontenierë por edhe nga mbledhja derë me derë si dhe nga mbledhësi informalë. Efektiviteti i qendrës ka qenë i ulët për shkak se nuk u bë pjesë e integruar e infrastrukturës për menaxhimin e mbetjeve dhe e kontratës së shërbimit me sipërmarrësin privat. Në përiudhën më të mirë kjo qendër ka përpunuar deri në 560 ton/vit mbetje të riciklueshme, dhe kështu mund të thuhet se ka qenë një eksperiment nga mësimet prej së cilës mund të projektohet një sistem më i plotë, i qëndrueshëm dhe funksional. Qendra mund të rikthehet jetë funksionale si objekt selektimi i përkohshëm në vitet në vazhdim për tu integruar në sistemin e diferencimit të mbetjeve.

Në qytet ekziston një rrjet mbledhësish informal të cilët, të organizuar në grupe ose në mënyrë individuale, kryejnë mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme (kryesisht letër, metal dhe plastikë) nëpër

pikat e grumbullimit të mbetjeve në qytet (duke rrëmuar brenda kontejnerëve). Gjithashtu, ekzistojnë disa biznese riciklimi që, nëpërmjet qendrave të grumbullimit, blejnë materiale të riciklueshme, kryesisht nga mbledhësit informalë, dhe i transportojnë ato në impiantet e tyre të riciklimit të vendosura në qytete të tjera të Shqipërisë.

### Kompostimi

Në Bashkinë Lezhë nuk raportohen nisma për kompostim edhe pse potenciali parashikohet të jetë i lartë pasi një pjesë e konsiderueshme e popullsisë jetojnë në zona rurale të cilët gjenerojnë sasi të vogla të mbetjeve inorganike dhe sasi të mëdha të mbetjeve organike. Megjithatë vlen për tu përmendur fakti që në zonat rurale të kësaj bashkie fermerët e kryejnë kompostimin e mbetjeve organike në mënyrën tradicionale.



Figura 4: Vend kompostimi familjar

### 5.3.3. Çështje financiare

Të dhënat mbi aspektet financiare të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë janë paraqitur në dy tabelat në vijim, të cilat grupojnë përkatësisht (i) çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues dhe (ii) të kostos së dhënies së shërbimit e buxhetimit të tij.

(i) çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues

Së pari, të dhënat e mbledhura tregojnë një diferencë të theksuar midis numrit të subjekteve të cilëve ju faturohet tarifa e shërbimit dhe numrit gjithsej të subjekteve pagues në secilën njësi administrative. Kjo diferencë është shumë e theksuar për familjet dhe më pak për bizneset, pra numri i familjeve të faturuara është shumë më i ulët se numri gjithsej i familjeve në njësitë administrative që marrin shërbim. Në lidhje me institucionet mungojnë thuajse fare të dhëna mbi faturimin, pagesën si dhe mbi masën e tarifave që janë zbatuar me vendim të pushtetit vendor.

Të dhëna 000 lekë/vit	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Bashkia Lezhë
<b>Të ardhura potenciale</b>	17,749	7,246	1,422	1,250	1,846	4,266	2,022	1,693	<b>37,496</b>
<b>Të ardhura nga tarifa</b>	15,134	1,968	597	456	872	2,032	879	185	<b>22,123</b>
<b>% të ardhurave faktike ndaj potenciale</b>	85%	27%	42%	36%	47%	48%	43%	11%	<b>59%</b>
<b>Mbledhja e tarifës familje</b>	20%	10%	21%	30%	na	30%	16%	20%	<b>21%</b>




<b>Mbledhja e tarifës biznese</b>	96%	89%	9%	73%	75%	57%	28%	3%	<b>73%</b>
<b>Mbledhja e tarifës institucione</b>	57%	0%	0%	0%	na	0%	0%	0%	<b>15%</b>

Tabela 6: Të dhëna financiare për menaxhimin e mbetjeve.

Së dyti, të dhënat tregojnë se aktualisht tarifa mbledhet ndjeshëm më pak nga familjet në krahasim me bizneset e faturuara për pjesën më të madhe të njësive administrative të Bashkisë Lezhë. Norma e mbledhjes së tarifës nga familjet luhetet nga 10% deri në 30%, ndërsa arrin deri në 90% për bizneset; nga ana tjetër, njësitë administrative Blinisht, Balldren dhe Dajç kanë norma farë të ulëta të mbledhjes së tarifës nga bizneset, përkatësisht 3%, 9% dhe 28%.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të përmbledhur gjendjen e mbledhjes së tarifës së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.



Grafiku 1: Grafiku mbi gjendjen e mbledhjes së tarifës së menaxhimit të mbetjeve sipas kategorive.

Shuma potenciale e të ardhurave nga niveli aktual i shërbimit, sipas tarifave që zbatohen aktualisht për subjektet pagues është përlogaritur në bazë të numrit të familjeve që marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve, numrit gjithsej të bizneseve, si dhe numrit gjithsej të institucioneve në Lezhë dhe Shëngjin.

(ii) çështje të kostos së dhënies së shërbimit e buxhetimit të tij

Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve zë mesatarisht 8% të buxhetit të vitit 2014 të Bashkisë Lezhë, i përlogaritur si shumë e buxheteve të të gjitha njësive administrative përbërëse, duke përjashtuar njësinë Ungrej për të cilën e dhëna mungon.

Të ardhurat nga tarifa mbulojnë koston operative të shërbimit (vlerën e kontratës me shoqëritë sipërmarrëse, pra koston operative me TVSH) përafërsisht në masën 43%.

Kosto për banor që marrin shërbim të rregullt është përafërsisht 755 lekë/vit.

Të dhëna 000 lek/vit	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Kolsh	Bashkia Lezhë
<b>Buxheti gjithsej</b>	300,000	143,654	46,554	22,933	24,000	50,000	18,218	16,942	25,000	<b>647,301</b>

<b>Buxheti për shërbimin</b>	18,750	19,680	2,488	1,311	1,938	5,606	900	500	na	<b>51,174</b>
<b>Vlera e kontratës</b>	18,750	19,680	2,488	1,311	1,938	5,606	960	480	834	<b>52,048</b>
<b>Kosto gjithsej e shërbimit</b>	24,350	16,400	2,074	1,092	1,615	4,672	960	480	695	<b>52,339</b>
<b>% koston e ndaj buxhetit gjithsej</b>	8%	11%	4%	5%	7%	9%	5%	3%	na	<b>8%</b>
<b>% koston e mbuluar nga të ardhurat</b>	81%	10%	24%	35%	45%	36%	92%	39%	na	<b>43%</b>
<b>Kosto (lekë/banor /vit)</b>	840	1,699	486	546	280	624	143	109	na	<b>755</b>

Tabela 7: Të dhëna mbi kostot dhe buxhetin e bashkisë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

#### 5.3.4. Mjetet

##### Kazanë

Të dhënat paraqesin se, Bashkia Lezhë ka të shpërndarë në territorin e saj gjithsej 963 kazanë, ose 9 kazanë për 1,000 banorë. Nga ky total, 283 janë në pronësi të saj dhe 680 kazanë janë në pronësi të shoqërive sipërmarrëse të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Të dhënat për kazanët e shpërndarë mungojnë për njësinë Kolsh e cila nuk ka ofruar shërbim të rregullt.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna më të detajuara mbi përmasat dhe gjendjen e tanishme të kazanëve në secilën njësi administrative.

Të dhëna	Lezhë	Shëngjin	Balldre	Kallmet	Zejmen	Shënkoll	Dajç	Blinisht	Bashkia Lezhë
<b>Pronësia e kazanëve</b>	BL	BL	S	S	S	S	NZ	NZ	
<b>Lloji i kazanëve</b>	1.1 m <sup>3</sup>	1.1 m <sup>3</sup> / 0.5 m <sup>3</sup>	1.1 m <sup>3</sup>	1.1 m <sup>3</sup>	1.1 m <sup>3</sup>	1.1 m <sup>3</sup> / 1.7 m <sup>3</sup>	1 m <sup>3</sup>	1 m <sup>3</sup>	
<b>Kazanë lloji 1100 lit.</b>	137	60	100	48	39	100	100	43	<b>627</b>
<b>Kazanë lloji 3200 lit.</b>	36								<b>36</b>
<b>Kazanë lloji 1600 lit.</b>	10								<b>10</b>
<b>Kazanë lloji 1700 lit.</b>						250			<b>250</b>
<b>Kazanë lloji 0.5 m<sup>3</sup></b>		40							<b>40</b>
<b>% e kazanëve në gjendje të mirë</b>	64%	30%	50%	90%	50%	60%	90%	70%	
<b>Lloji i kazanëve R</b>	1.6 m <sup>3</sup> / 3.2 m <sup>3</sup>	na							
<b>Numri i kazanëve R</b>	46	na							
<b>Numri i kazanëve / 1000 banorë</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>12</b>	<b>4</b>	<b>22</b>	<b>14</b>	<b>8</b>	<b>9</b>

Tabela 8: Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Megjithatë qëndron si problematikë kryesore niveli i dëmtimit të këtyre kontenierëve të cilët në shumicën e rasteve janë të papërdorshëm. Si shkak i keqpërdorimit por edhe i dëmtimit nga persona të ndryshëm kanë bere qe këta kontenierë të kenë nevojën e zëvendësimit të plote të tyre, në shumicën e rasteve, por edhe riparimin e atyre që janë në një gjendje pak më të mirë.



Figura 5: Pamje nga kontenierë të dëmtuar.

#### Kamionë

Në bazë të të dhënave të mbledhura, Bashkia Lezhë aktualisht ka në pronësi të saj gjithsej vetëm 1 kamion për mbledhjen e mbetjeve urbane, 7 ton, i cili nuk është në gjendje pune. Mjete të tjera për mbledhjen në pronësi të saj janë 2 fadroma dhe 1 ekskavator.

Sipërmarrësit e tjerë të cilët operojnë në Bashkinë Lezhë aktualisht, sipas të dhënave, kanë në pronësi 3 kamionë me ngjeshje 10 ton, 2 kamionë të hapur 6 ton dhe 7 ton, dhe 1 kamionçinë.

Megjithatë, të dhënat mbi mjetet në pronësi të shoqërive sipërmarrëse nuk janë të plota për të përlogaritur me besueshmëri numrin e kamionëve që veprojnë për 1,000 banorë.

#### 5.4. Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare

Duke marrë si bazë referençe vitin 2015, shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë ka një kosto gjithsej prej rreth **52,339,085** lekë/vit, me vlerë gjithsej të kontratave të sipërmarrjes **52,048,735** lekë/vit.

- Shërbimi ofrohet përafërsisht për **66%** të popullsisë. Në njësinë administrative *Ungrej* shërbimi nuk ofrohet, ndërsa në Kolsh ofrohet pjesërisht.
- Shpeshtësia (frekuenca) e mbledhjes së mbetjeve urbane është 7 herë / javë për zonën urbane të Lezhës dhe Shëngjinit dhe 1, 2 deri 3 herë në javë për zonat rurale ku përfshihen të gjitha njësitë e tjera administrative.
- Me riorganizimin administrativ dhe territorial të pushtetit vendor, objektivi strategjik i Bashkisë Lezhë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është njësimi i tij në të gjithë territorin e saj.
- Deri me tani, kontratat e sipërmarrjes në fuqi dhe mungesa e një plani të menaxhimit të mbetjeve i cili të përfshijë territorin e ri, nuk kanë lejuar ndërmarrjen e hapave të menjëhershëm për përmbushjen e këtij objektivi strategjik.

### 6. Nevojat dhe prioritetet

Gjenerimi i mbetjeve në territorin e bashkisë ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, i cili është prioriteti kryesor i bashkisë Lezhë nga pikëpamja ekonomike si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Nevojat të cilat duhen marre parasysh në zbatimin e planit në harmoni dhe me planin për mbrojtjen e mjedisit në planin vendor të bashkisë janë renditur si me poshtë:

- Rehabilitimi i zonave me ndotje të lartë mjedisore, rinovimi urban dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zone të gjelbra me vlere rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;

- Identifikimi i të gjitha pikave të ligjshme dhe të paligjshme të hedhjes së mbetjeve;
- Inventarizimi dhe diagnostikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe raportimi;
- Zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme të menaxhimit të mbetjeve;
- Aprovimi i një buxheti të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat;
- Hartimi i programeve për diferencimin që në burim të mbetjeve;
- Ngritjes së një qendre multifunktionale ose përndryshe Objekti për Reduktimin e Mbetjeve që do të shërbejë për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane duke përfshirë, mbetjet voluminoze, kompostimin dhe selektimin e mbetjeve të riciklueshme;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme;
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve dhe monitorimi i shërbimit në përgjithësi.

## 7. Qëllimi, objektivat dhe rezultatet

Qëllimi dhe parimet e bashkisë Lezhë për menaxhimin e mbetjeve burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe ambicia e Shqipërisë për tu afruar me standardet evropiane në përputhje me Direktivat respektive të BE në këtë fushë.

Objekti i këtij plani janë mbetjet e ngurta bashkiake, të cilat përgjithësisht përcaktohen si mbeturina shtëpiake, mbeturina të ngurta të parrezikshme të aktivitetit tregtar, institucioneve, tregjeve, mbeturina nga oborret dhe nga fshirja e rrugëve. Menaxhimi i Mbetjeve përmbledh aktivitetet grumbullimin, transportin, depozitimin dhe trajtimin e tyre.

Qëllimi universal i PMIM i bashkisë Lezhë, do të përmbledhet si në vijim:

*“Të realizojë një shërbim efektiv dhe eficient, për të gjithë banorët dhe ta shtrijë në të gjithë territorin me një standard të përballueshëm prej tyre në mënyrë që të mbrojë mjedisin dhe të sigurojë kushte të shëndetshme dhe të sigurt për jetën dhe aktivitetin e banorëve; të nxisë rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve; të mbështesë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të gjenerojë punësim dhe të ardhura”*

### 7.1. Objektivat e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Lezhë

Objektivat e bashkisë Lezhë për menaxhimin e mbetjeve bazohen mbi objektivin kombëtar siç janë specifikuar nga VKM Nr. 418, datë 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, si dhe të VKM 608, datë 17/09/2014, të cilët në mënyrë të përmbledhur shprehen respektivisht:

- *Objektivi për t’u arritur nga njësitë e qeverisjes vendore brenda datës 31 Dhjetori 2020, për përgatitjen, ripërdorimin, riciklimin e mbetjeve të ngurta, ku përfshihen letra, metali, plastika dhe qelqi, dhe kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme duhet të arrijnë minimumi në 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve të gjeneruara në vitin [2015]<sup>6</sup> (sipas auditit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve).*

<sup>6</sup> Sipas legjislacionit në fuqi ripërdorimi, riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve duhet të arrijë minimumin e 50% të mbetjeve të gjeneruara në vitin 2014

Në këtë kontekst, objektivat e PMIM për bashkinë Lezhë janë:

1. Të shtrijë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove në 95% të territorit të bashkisë.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brenda territorit të bashkisë.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbetjeve.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

Zbatimi i këtij Plani do të shtrihet në harkun kohor 5 vjeçar 2017 – 2021. Treguesit dhe buxheti i zbatimit të Planit monitorohen dhe rishikohen çdo vit në kuadër të procesit të përgatitjes së paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të bashkisë.

## Objektiva sipas Planit Kombëtar

1

Deri në v.2018 duhet bërë grumbullim i ndarë për letër, metal, plastikë dhe qelq

## Objektiva sipas Planit të Bashkisë Lezhë

V.2017: Në zonat urbane të bashkisë mbetjet grumbullohen e mblidhen të ndara me kontenierë të veçantë dhe

V.2018: Në të gjithë territorin e bashkisë do të fillojë grumbullimi i ndarë i mbetjeve në 2 rryma

V.2020-2021: Në 95% të territorit të bashkisë mblidhen mbetjet të ndara Zonat I+II+III ose në 100% të familjeve, mbetjet grumbullohen e mblidhen të ndara

## Objektiva sipas Planit Kombëtar

2

Deri në v.2020 përgatitja për riciklim i mbetjeve letër, metal, plastikë dhe qelq, do të rritet me 50% të peshës së përgjithshme të mbetjeve

## Objektiva sipas Planit të Bashkisë Lezhë

V.2017 17% e peshës së mbetjeve përgatiten për riciklim nga mbledhja e diferencuar

V.2019 40% e peshës së mbetjeve përgatiten për riciklim nga mbledhja e diferencuar

V.2020-2021 50 % e peshës së mbetjeve përgatiten për riciklim nga mbledhja e diferencuar

## Objektiva sipas Planit Kombëtar

3

Deri në v.2020 të riciklohet/kompostohet 25% e mbetjeve bashkiake

## Objektiva sipas Planit të Bashkisë Lezhë

V.2018: 13 % e mbetjeve (letër, qelq) do të riciklohen nga biznesi RC

V.2019: 24 % e mbetjeve (letër, qelq) do të riciklohen nga biznesi RC

V.2020-2021: 29 % e mbetjeve (letër, qelq) do të riciklohen nga biznesi RC

## Objektiva sipas Planit Kombëtar (sipas BE 35% viti 2016)

4

Deri në v.2025 të reduktohet depozitimi i mbetjeve në landfill në rreth 30%

## Objektiva sipas Planit të Bashkisë Lezhë

V.2018: 83 % e mbetjeve shkojnë në landfillin e Bushatit

V.2019: 70 % e mbetjeve shkojnë në landfillin e Bushatit

V.2020-2021 60 % e mbetjeve shkojnë në landfillin e Bushatit

Përsa i përket realizimit të objektivave është pare e nevojshme ndarja e territorit të bashkisë në 3 zona shërbimi:

**Zona e I-rë** mbulon Njësitë Administrative:

1. Lezhë;
2. Shëngjin;

Shërbimi mbulon territorin e Zonës së I-rë të Bashkisë Lezhë (harta në vijim). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës I - rë të shërbimit është vlerësuar rreth 21,089 banorë (e llogaritur për vitin 2015-16) në sezonin e Shtator – Maj, e cila shtohet me rreth 35, 714 për çdo ditë në sezonin Qershor – Gusht veçanërisht në zonën e Shëngjinit. Numri i popullsisë që do të marrin shërbim në këtë Zonë në vitin 2021 është vlerësuar ne rreth 30,234 banorë rezidentë (pa përfshirë këtu popullsinë vizitore (turistët).

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njësie Administrative ku shtrihet shërbimi.




Figura 6: Shtrirja e zonave të shërbimit të ndara sipas kategorive.

**Zona II** mbulon Njësitë Administrative:

1. Shënkoll;
2. Zejmen;
3. Kolsh;

Kufijtë e Zonës së Shërbimit nuk përputhen domosdoshmërisht me kufijtë administrativ të Njësie Administrative ku shtrihet shërbimi.



Shërbimi mbulon të gjithë territorin e Zonës II të Bashkisë Lezhë (figura. 5). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës II të shërbimit e llogaritur rreth 24,029 banorë (e llogaritur për vitin 2016).

**Zona III** mbulon Njësitë Administrative:

1. Balldre;
2. Kallmet;
3. Ungrej;
4. Dajç;
5. Blinisht;

Kufijtë e Zonës së Shërbimit për zonën e III-të përputhen me kufijtë administrativ të Njësite Administrative ku shtrihet shërbimi. Shërbimi mbulon të gjithë territorin e Zonës III të Bashkisë Lezhë (figura. 5). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të Zonës III të shërbimit e llogaritur rreth 24,186 banorë (e llogaritur për vitin 2016).

## 7.2. Rezultatet dhe treguesit

### Rezultatet

Përcaktimi i rezultateve të dëshiruara qëndron në thelb të punës për hartimin e PMIM-së, bazuar mbi matjen e performancës. Përcaktimi i rezultateve dhe treguesve shërben për të gjeneruar ide, për të vendosur dhe menduar se çfarë do të jetë më e rëndësishme, si dhe për të marrë një vendim përfundimtar mbi zhvillimin e shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve. Shtresëzimi i rezultateve, nga disa rezultate të ndërmjetme deri tek rezultati përfundimtar, ndihmon për të bërë zgjedhjet e duhura, si në rastin e këtij Plani, për të mos zbehur fokusin e përpjekjeve për të përmirësuar shërbimin dhe për të lehtësuar procesin e matjes dhe monitorimin performancës së Bashkisë në këtë fushë.

Për të përmbushur objektivat e këtij plani, bashkia Lezhë ka vendosur këto tregues për objektivat që do të realizohen nga zbatimi i Planit.

**Objektivi 1: Te shtrijë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove në 95% të territorit të bashkisë.**

Objektivi 1: Te shtrijë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove në 95% të territorit të bashkisë							
Bashkia Lezhë		Mbulimi me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave					
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2015-16	2017	2018	2019	2020	2021
Zona e I është mbuluar 95 % me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.	Zona I	75%	80%	90%	95%	99%	99%
	Zona II	65%	75%	82%	89%	95%	97%
	Zona III	44%	55%	64%	72%	81%	89%



<b>Totali</b>	<b>B. Lezhë</b>	<b>63%</b>	<b>70%</b>	<b>80%</b>	<b>89%</b>	<b>92%</b>	<b>95%</b>
---------------	-----------------	------------	------------	------------	------------	------------	------------

Tabela 9: Objektivi 1 i ofrimit të shërbimit.

Në fund afatit të zbatimit të planit (2021) bashkia do të synojë të mbulojë dhe të grumbullojë mbetjet nga jo më pak se 95% e territorit të saj.

**Objektivi 2: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të bashkisë.**

Në lidhje me këtë objektiv bashkia Lezhë synon:

- Të planifikoje një sistem adekuat të grumbullimit të mbetjeve duke krijuar itinerare për secilën zone shërbimi dhe orare të përshtatshme për të siguruar tërheqjen e të gjitha mbetjeve të gjeneruara.

<b>Objektivi 2: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të bashkisë.</b>							
<b>Bashkia Lezhë</b>		<b>Largimi i të gjitha mbetjeve të gjeneruara në territorin e bashkisë.</b>					
<b>Rezultati</b>	<b># Zona</b>	<b>Viti bazë 2015</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
% e popullsisë totale që merr shërbimin të rregullt të largimit të mbetjeve të ngurta urbane.	Zona I	75%	80%	90%	95%	99%	99%
	Zona II	65%	75%	82%	89%	95%	97%
	Zona III	44%	55%	64%	72%	81%	89%
<b>Totali</b>	<b>B. Lezhë</b>	<b>63%</b>	<b>70%</b>	<b>80%</b>	<b>89%</b>	<b>92%</b>	<b>95%</b>

Tabela 10: Objektivi 2 i ofrimit të shërbimit.

**Objektivi 3: Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve.**

Për të arritur këtë objektiv, bashkia Lezhë do të synojë ofrimin e këtij shërbimi në dy standarde sipas ndarjes territoriale në tre zonat e shërbimit.

**1. Zona e I-rë:**

- Qyteti Lezhë: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë në vitin 2017;
- Qyteti i Shëngjinit: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë në vitin 2017, në të gjithë qytetin gjatë verës dhe vetëm në pjesën e qendrës gjatë periudhës së dimrit.

**2. Zona e II-të**

- Në Zonën e II-të, procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë nga viti 2017;

### 3. Zona e III-të

- Në zonën e III-të procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të zgjerohet përgjatë vitit 2019-2021.

### 4. E gjithë bashkia

- Përsa i përket riciklimit në zonat rurale të bashkisë Lezhë do të filloje pilotimin e mbledhjes derë me derë të mbetjeve të riciklueshme me qese 1 here në javë në zona të cilat do të përzgjidhen nga bashkia gjatë vitit 2018.
- Gjate viteve 2019-2021 shërbimi do të shtrihet në 95% të territorit të bashkisë.

Tabela e rezultateve dhe tregueseve të indikatorëve për Objektivin 3 paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Objektivi 3: Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit							
Bashkia Lezhë			Mbulimi me shërbimin e grumbullimi të diferencuar dhe ndarjen në burim				
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2015-16	2017	2018	2019	2020	2021
Në qytetin e Lezhës është vendosur një sistem efektiv për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme	Zona I	0%	10%	20%	35%	45%	50%
	Zona II	0%	10%	20%	35%	45%	50%
	Zona III	0%	10%	20%	35%	45%	50%
Në qytetin e Lezhës është vendosur një sistem efektiv për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve për kompostim	Zona I	0%	0%	15%	20%	25%	35%
	Zona II	0%	0%	15%	20%	25%	35%
	Zona III	0%	0%	15%	20%	25%	35%
<b>Rezultati Bashkia Lezhë Riciklim</b>		0%	10%	20%	35%	45%	50%
<b>Rezultati Bashkia Lezhë kompostim</b>		0%	0%	15%	20%	25%	35%

Tabela 11: Objektivi 3 i ofrimit të shërbimit.

**Objektivi 4: Të siguroje reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në landfill si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.**

Duke u bazuar në rezultatet e mësipërme për riciklimin e mbetjeve të njoma dhe të thata, bashkia ka vendosur një objektiv specifik për reduktimin e mbetjeve të cilat depozitohen në landfillin e Bushatit.

Në këtë mënyrë parashikohet që në të gjithë territorin e bashkisë në fund të afatit të këtij plani sasia e mbetjeve që depozitohen në landfill do të reduktohen me rreth 40%.

**Objektivi 4: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të bashkisë.**

Bashkia Lezhë		Reduktimi i mbetjeve					
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2015	2017	2018	2019	2020	2021
% mbetjeve të reduktuara të cilat janë të destinuara të shkojnë në vend depozitim.	Zona I	0%	3%	17%	25%	31%	40%
	Zona II	0%	3%	17%	25%	31%	40%
	Zona III	0%	3%	17%	25%	31%	40%
<b>Totali</b>	<b>B. Lezhë</b>	0%	3%	17%	25%	31%	40%

Tabela 12: Objektivi 4 i ofrimit të shërbimit.

**Objektivi 5: Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës.**

Për të realizuar këtë objektiv, bashkia do të vendosi një sistem tarifor i cili do të mbulojë kostot e ofrimit të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane nga territori i bashkisë.

Gjithashtu norma e mbledhjes së tarifave do të planifikohet e njëjtë pavarësisht zonave të shërbimit. Kjo për arsye se llogaritja e kostove është ndare sipas Zonave të shërbimit.

Ne lidhje me koston (5.1) dhe të ardhurat (5.2):

**Objektivi 5.1 : Mbulimi i kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit**

Indikatorët e Rezultatit 2016 – 2020							
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2015 -16	2017	2018	2019	2020	2021
Kosto e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave mbulohet nga të ardhurat prej tarifës së këtij shërbimi	Zona I	56%	80 %	90 %	95 %	95 %	95 %
	Zona II	26.4%	80 %	90 %	95 %	95 %	95 %
	Zona III	31.6	80 %	90 %	95 %	95 %	95 %

**Objektivi 5.2 : Rritja e mbledhjes së të ardhurat prej tarifës së shërbimit**

Indikatorët e Rezultatit 2016 – 2020							
--------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

<b>Rezultati</b>	<b># Zona</b>	<b>Viti bazë 2015</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
Tarifa e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga familjet mblidhet në të gjithë bashkinë Lezhë	Zona I	56%	60%	70%	80%	90%	95%
	Zona II	26.4%	40%	50%	60%	70%	80%
	Zona III	31.6	40%	45%	50%	55%	60%

Tabela 13: Objektivi 5 i ofrimit të shërbimit.

## 8. Plani operativ i menaxhimit të integruar të mbetjeve

### Projeksioni i popullsisë 2017-2021

Duke marrë në konsideratë një rritje të popullsisë prej 0,5% në vit (afërsisht sa rritja natyrore mesatare vjetore kombëtare, popullsia në bashkinë Lezhë në vitin 2021 parashikohet në rreth 78,448 banorë.


Tabela në vijim pasqyron projeksionin e popullsisë për çdo Zone Shërbimi në bashkinë Lezhë në përgjithësi në intervalin kohor 2017 – 2021 duke u nisur nga të dhënat e vitit 2015 si viti krahasimor bazë në hartimin e këtij Plani.

Numri i popullsisë gjithsej		2017	2018	2019	2020	2021
<b>Zona I</b>	Lezhë-Shëngjin	29,636	29,785	29,933	30,083	30,234
<b>Zona II</b>	Kolsh-Zejmen-Shënkoll	23,555	23,672	23,791	23,910	24,029
<b>Zona III</b>	Balldre-Kallmet-Dajç-Blinisht-Ungrej	23,708	23,826	23,946	24,065	24,186
		<b>76,899</b>	<b>77,283</b>	<b>77,670</b>	<b>78,058</b>	<b>78,448</b>

Tabela 14: Projeksioni i popullsisë<sup>7</sup> në Bashkinë Lezhë 2017- 2021.

Në vijim grafiku ilustron në mënyrë të përmbledhur projeksionin e popullsisë në bashkinë Lezhë.

<sup>7</sup> Te dhënat e popullsisë janë llogaritur sipas formulës se cituar në Ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016” me rritje natyrore 0.5%/vit.



Grafiku 2: Projeksioni i popullsisë 2017 – 2021, Bashkia Lezhë

### Sasia dhe struktura e përbërjes së mbetjeve

Sasia aktuale totale e mbetjeve llogaritet në rreth 17,000 ton/vit duke marrë në konsideratë normat 0.7 kg/banor/ditë për zonat urbane dhe 0.44 kg/banor/ditë për zonat rurale<sup>8</sup>. Në vitin 2017 sasia e mbetjeve që gjenerohen në Lezhë vlerësohet rreth 17,180 ton/vit ndërsa në 2021 kjo sasi parashikohet në rreth 18,400 ton/vit.

Nga llogaritjet rezulton se rreth 31 % e mbetjeve në Lezhë përbëhen nga fraksione të riciklueshme përfshirë letër/karton, plastikë, qelq, metale. Politika e bashkisë në këtë kuadër do të fokusohet në ndarjen në burim të këtyre mbetjeve, grumbullimin, selektimin dhe tregtimin e tyre për industrinë e riciklimit, duke reduktuar kështu ndjeshëm mbetjet me destinacion venddepozitimin e Bushatit në përputhje më afate ligjore.

Rreth 69% e mbetjeve të Bashkisë Lezhë aktualisht janë mbetje të biodegradueshme (organike, dru dhe mbetje nga kuzhina, oborri, kafshët etj.), të përziera me mbetje të pa riciklueshme që do të thotë se në termat e Direktivave të BE mbi Landfillet dhe SKMM, politikat e Bashkisë duhet të adresojnë menaxhimin e kësaj rryme në mënyrë të tillë që të inkurajojë kompostimin. Në mënyrë të veçantë bashkia do të inkurajojë këtë lloj trajtimi në zonat e thella rurale në mënyrë që të ulen kostot e transportit si dhe sasia e mbetjeve me destinacion landfillin.

<i>Sasia e gjeneruar e mbetjeve sipas llojit</i>					
	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Mbetje të pariciklueshme</b>	<b>11,854.2</b>	<b>12,055.5</b>	<b>12,260.4</b>	<b>12,468.9</b>	<b>12,681.1</b>
<b>Mbetje të riciklueshme gjithsej</b>	<b>5,325.8</b>	<b>5,416.3</b>	<b>5,508.3</b>	<b>5,602.0</b>	<b>5,697.3</b>
<i>letër/karton</i>	<i>1,384.7</i>	<i>1,408.2</i>	<i>1,432.2</i>	<i>1,456.5</i>	<i>1,481.3</i>
<i>plastike</i>	<i>692.4</i>	<i>704.1</i>	<i>716.1</i>	<i>728.3</i>	<i>740.6</i>
<i>qelq</i>	<i>2,929.2</i>	<i>2,978.9</i>	<i>3,029.6</i>	<i>3,081.1</i>	<i>3,133.5</i>
<i>metal</i>	<i>319.5</i>	<i>325.0</i>	<i>330.5</i>	<i>336.1</i>	<i>341.8</i>
<b>Mbetje gjithsej</b>	<b>17,180.0</b>	<b>17,492.9</b>	<b>17,790.2</b>	<b>18,092.7</b>	<b>18,400.6</b>

Tabela 15: Gjenerimi, struktura në % (përbërja) e mbetjeve sipas studimit të Institutit të Kërkimeve Urbane në Lezhë dhe Shëngjin (2013).

<sup>8</sup> Të dhënat për sasinë e mbetjeve të gjeneruara për çdo banorë në ditë janë marrë në analogji me matje që janë bërë në Bashkinë Lezhë prej Institutit të Kërkimeve Urbane në vitin 2013.

### **Norma e gjenerimit të mbetjeve**

Në mungesë të matjeve zyrtare me të fundit në Bashkinë Lezhë lidhur me sasinë e mbetjeve të ngurta urbane që gjenerohen si në zonat urbane dhe ato rurale, për të bërë një përafrim të situatës në këtë drejtim, janë përdorur të dhëna të cilat janë gjeneruar nga studimi i “Vlerësimit të sasisë së mbetjeve në Lezhë dhe Shëngjin”<sup>9</sup>.

- Norma e gjenerimit të mbetjeve nga popullsia urbane është konsideruar 0.7 kg/banor/ditë.
- Norma e gjenerimit të mbetjeve nga popullsia rurale është konsideruar 0.44 kg/banor/ditë.
- Pjesa në vlerë relative e mbetjeve të riciklueshme 31%
- Pjesa në vlerë relative e mbetjeve të biodegradueshme 69%

Normat e tjera në vijim janë përdorur për llogaritjen e numrit të kontenierëve në vitet e zbatimit të planit. Këto norma përpunohen me matjet e bëra në terren <sup>10</sup> dhe janë përdorur për analogji për hartimin e PMIM të bashkisë së Lezhës.

- Pesha mesatare e mbetjeve në një kontejner 1100 litra ose 1.1 m<sup>3</sup> është 250 kg
- Pesha mesatare e mbetjeve mikse në një kontenierë 1100 litra ose 1.1 m<sup>3</sup> i mbushur 85% plote = 212.5 kg
- Pesha mesatare e mbetjeve të riciklueshme në një kontenier 1100 litra ose 1.1 m<sup>3</sup> është 150kg
- Pesha mesatare e mbetjeve të riciklueshme në një kontenierë 1100 litra ose 1.1 m<sup>3</sup> i mbushur 75% plote = 112.5 kg

Mbi bazën e shtimit të popullsisë si dhe të një rritje të gjenerimit të mbetjeve prej 1.3 % në vit për çdo vit të planit, në tabelën që vijon është paraqitur llogaritja e gjenerimit të mbetjeve për periudhën kohore të planit duke marrë si vit bazë të dhënat e vlerësuara për vitin 2015.


Sasia e gjeneruar mbetje gjithsej		2017	2018	2019	2020	2021
<b>Zona I</b>	Lezhë-Shëngjin	9,813.2	9,993.1	10,154.9	10,319.5	10,486.9
<b>Zona II</b>	Kolsh-Zejmen-Shënkoll	3,702.6	3,769.5	3,837.6	3,906.9	3,977.5
<b>Zona III</b>	Balldre-Kallmet-Dajç-Blinisht-Ungrej	3,664.1	3,730.3	3,797.7	3,866.3	3,936.2
	<b>Total</b>	<b>17,180</b>	<b>17,493</b>	<b>17,790</b>	<b>18,092</b>	<b>18,400</b>

Tabela 16: Projektioni i gjenerimit të mbetjeve 2017 – 2021

Në grafikun që vijon janë ilustruar në mënyrë të përmbledhur rezultatet e tabelës më sipër për të treguar projektionin e gjenerimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë në intervalin 2017 – 2021.

<sup>9</sup> Të dhënat në këtë studim janë bazuar mbi matje fizike në vend. Studimi është realizuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 2013-2014

<sup>10</sup> Vlerësimi i sasisë dhe llojit të mbetjeve në bashkinë Lezhë dhe Komunën Shëngjin, viti 2013. Realizuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane në kuadër të projektit DLDP



Grafiku 3: Projeksioni i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë

### 8.1. Planifikimi teknik i menaxhimit të mbetjeve

#### Projeksioni për mbulimin me shërbimin e largimit të mbetjeve

Në terma relative dhe vlera të bazuara mbi llogaritjen e mesatares së ponderuar, në bashkinë Lezhë aktualisht mbulohet me shërbim rreth 66 % e popullsisë. Për qëllimet e këtij plani në Tabelat që vijojnë pasqyrohen gjendja aktuale e mbulimit dhe projeksionin sipas Zonave të Shërbimit dhe mesataren e ponderuar për Bashkinë Lezhë nga 2017 deri në vitin 2021

Zona	Operacioni	vitet	2017	2018	2019	2020	2021
I	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	9,813	9,993	10,154	10,319	10,486
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	7,850	8,993	9,646	10,215	10,381
	Mbetje qe nuk mblidhen	ton/vit	1,963	1,000	508	104	105
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	20%	10%	5%	1%	1%

Zona	Operacioni	vitet	2017	2018	2019	2020	2021
II	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	3,702	3,769	3,837	3,906	3,977
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	2,776	3,090	3,415	3,710	3,857
	Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	926	679	422	196	120
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	25%	18%	11%	5%	3%

Zona	Operacioni	vitet	2017	2018	2019	2020	2021
III	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	3,664	3,730	3,797	3,866	3,936
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	1,612	2,051	2,430	2,783	3,188
	Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	2,052	1,679	1,367	1,083	748
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	56%	45%	36%	28%	19%

Tabela 17: Projeksioni i mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë sipas zonave të shërbimit 2017 - 2021.

Bashkia	Operacioni	Vitet	2017	2018	2019	2020	2021
Lezhë	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	17,180	17,492	17,790	18,092	18,400


Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	12,238	14,134	15,491	16,708	17,426
Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	4,942	3,358	2,299	1,384	974
% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	<b>30%</b>	<b>20%</b>	<b>11%</b>	<b>8%</b>	<b>5%</b>

Tabela 18: Projektioni i mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë 2017 - 2021.

Duke rritur gradualisht mbulimin me shërbim, veçanërisht duke e shtrirë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve edhe në ato njësi në të cilat ky shërbim nuk ofrohet, në vitin 2021, sipas planit të propozuar, bashkia Lezhë do të jetë në gjendje që ta ofrojë këtë shërbim në jo më pak se 95 % të territorit ose të popullsisë që jeton në këtë bashki.


Kjo % merr në konsideratë mbulimin 99 % për zonën e parë të shërbimit, mbulim 97% për zonën e dytë të shërbimit dhe mbulimin deri në 89 % për zonën e tretë të shërbimit, e cila është e përbërë nga relativisht zona të thella malore ku aksesimi me rrugë është i pamundur.

Grafiku në vijim ilustron planifikimin e rritjes së mbulimit me shërbim në harkun kohor 2017 – 2021, krahasuar me vitin 2015.



Grafiku 4: Rritja e mbulimit me shërbim sipas zonave të Shërbimit, 2017 - 2021

Në total dhe për të gjithë territorin e bashkisë projektioni i mbulimit me shërbim në fund të periudhës së zbatimit të planit është projektuar në masën 95 %. Grafiku në vijim pasqyron ndryshimin e mbulimit me shërbim për të gjithë bashkinë Lezhë në harkun kohor 2017 – 2021.





Grafiku 5: Rritja e mbulimit me shërbim në bashkinë Lezhë, 2016 - 2020

### Projeksioni për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

Një nga treguesit kryesorë të këtij plani është projeksioni për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Mbi bazën e këtij treguesi, dhe në varësi të formës që bashkia do të zgjedhe për administrimin e këtij shërbimi, bashkia do të planifikojë shpërndarjen e burimeve, përfshirë këtu ato njerëzore, mjetet financiare teknike dhe makineritë.

Projeksioni për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve është bazuar në projeksionet e mësipërme të cilat janë thelbësore për llogaritjen e projeksionit të grumbullimit dhe transportit.

Nga këto mund të përmendim:

1. projeksionin e popullsisë;
2. projeksionin e gjenerimit të mbetjeve, si dhe
3. projeksionin e shtrirjes së mbulimit me shërbim.

Llogaritja e projeksionit për këtë tregues është bërë për secilën zonë shërbimi. Baza e të dhënave që shoqëron këtë plan përmban llogaritjet për çdo Njësi Administrative.

Zona	Operacioni	vitet	2017	2018	2019	2020	2021
I	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	9,813	9,993	10,154	10,319	10,486
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	7,850	8,993	9,646	10,215	10,381
	Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	1,963	1,000	508	104	105
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	20%	10%	5%	1%	1%

Zona	Operacioni	vitet	2017	2018	2019	2020	2021
II	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	3,702	3,769	3,837	3,906	3,977
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	2,776	3,090	3,415	3,710	3,857
	Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	926	679	422	196	120
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	25%	18%	11%	5%	3%


Zona	Operacioni	vitet	2017	2018	2019	2020	2021
III	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	3,664	3,730	3,797	3,866	3,936
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	1,612	2,051	2,430	2,783	3,188
	Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	2,052	1,679	1,367	1,083	748
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	56%	45%	36%	28%	19%

Tabela 19: Projeksioni i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, si dhe i mbetjeve që nuk mblidhen në ton/vit, (2015) 2017 – 2021.

Llogaritjet e agreguara për të gjithë territorin e bashkisë Lezhë na japin situatën si në tabelën përmbledhëse që vijon.

Bashkia Lezhë	Operacioni	Vitet	2017	2018	2019	2020	2021
	Sasia e gjeneruar e mbetjeve	ton/vit	17,180	17,492	17,790	18,092	18,400
	Mbledhja e mbetjeve	ton/vit	12,238	14,134	15,491	16,708	17,426
	Mbetje që nuk mblidhen	ton/vit	4,942	3,358	2,299	1,384	974
	% e mbetjeve që nuk mblidhen	%	<b>30%</b>	<b>20%</b>	<b>11%</b>	<b>8%</b>	<b>5%</b>

Tabela 20: Projektioni i grumbullimit të mbeturinave në gjithë bashkinë 2017 - 2021.




Grafiku 6: Projektioni i mbetjeve të pa menaxhuara

Tabela e mësipërme tregon që në periudhën e fundit të zbatimit të këtij plani, në terma absolutë, sasia e mbetjeve që do gjenerohet në territorin e bashkisë Lezhë në vitin 2021, duke marrë parasysh rritjen e popullsisë me 0.5% në vit dhe rritjen e gjenerimit me 1.3% në vit, është llogaritur të jete 18,400.6 ton/vit prej të cilave do të mblidhen rreth 95 % krahasuar më 63 % që mblidhen aktualisht.

- ✓ Duhet të sqarohet që mbetjet që nuk do të grumbullohen i përkasin kryesisht fshatrave që aktualisht nuk aksesohen me rrugë.

Vlen të theksohet se treguesi i “Mbetjeve që nuk Mblidhen” ose i mbetjeve që do të vazhdojnë të hidhen në mënyrë të pakontrolluar do të ulet në nivele maksimale siç parashikohet në vetëm 5 % të sasisë së mbetjeve që do të gjenerohen në të gjithë territorin e bashkisë.

Grafiku në vijim ilustron ndryshimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, si dhe sasinë e mbetjeve që nuk mblidhen, rrjedhimisht që depozitohet në mënyrë të pakontrolluar nga viti 2017 në vitin 2021 në ton/vit.



Grafiku 7: Projeksioni i raportit të mbetjeve që gjenerohen dhe që nuk mblidhen në bashkinë Lezhë, 2017 – 2021.

Këto projeksione tregojnë për një plan ambicioz të bashkisë Lezhë si dhe një rritje të ndjeshme të mbulimit dhe cilësisë së shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.

#### **Projeksioni për shpërndarjen e kontenierëve dhe frekuencat e grumbullimit**

Ky plan ka për qëllim gjithashtu të pasqyrojë një projeksion të detajuar të nr. të PGM, nr. e kontenierëve dhe përbërjen e çdo PGM-je për të gjitha zonat e shërbimit. Autoriteti përkatës që do të merret me ofrimin e shërbimit do të furnizojë dhe vendosë në sistem gjithsej 1,023 kontenierë ne periudhën qershor - gusht dhe 1,119 kontenierë në periudhën shtator – maj (sasia e kontenierëve në përdorin jashtë sezonit turistik do të ulet me 96 kontenierë për zonën I).

#### **Përsa i përket Zonës së I-rë të shërbimit**

Njësia Administrative Lezhë

Nga kjo sasi kontenierësh, autoriteti përkatës që do të merret me ofrimin e shërbimit do të vendosë në qytetin e Lezhës gjatë gjithë vitit 200 kontenierë, prej të cilave:

- 19 kontenierë për mbetje mikse
- 101 kontenierë për mbetje te përziera dhe te pariciklueshme; dhe
- 80 kontenierë për mbetjet te riciklueshme te thata

Të gjithë këta kontenierë do të shpërndahen në **96 PGM** sipas itinerareve:

- 18 PGM për mbetjet mikse (17 pika me 1 kontenier dhe 1 pike me 2 kontenierë);
- 57 PGM për grumbullim te diferencuar (të përbërë nga 1 + 1 kontenierë);
- 19 PGM për grumbullim te diferencuar (të përbërë nga 2 + 1 kontenierë);
- 1 PGM për grumbullim te diferencuar (të përbërë nga 3 + 1 kontenierë);
- 1 PGM për grumbullim te diferencuar (të përbërë nga 3 + 3 kontenierë);

Njësia Administrative Shëngjin

Në NJA Shëngjin, numri i kontenierëve dhe i PGM-ve do të jetë i ndryshëm në periudhën shtator – maj dhe qershor – gusht për shkak të zhvillimit të turizmit në këtë zonë. Operatori do të vendosë në **217** gjatë sezonit turistik dhe **121** kontenierë në periudhën shtator - maj:

- 217 kontenierë (96 kontenierë shtesë) të shpërndarë në 115 PGM nga të cilat 45 me nga 1 kontenierë për mbetje mikse të pariciklueshme, 70 PGM për grumbullim të diferencuar prej të cilave 42 me përbërje 1+1, 24 PGM me përbërje 1+2 kontenierë, dhe 4 PGM me përbërje 2+2, për periudhën qershor – gusht.
- 121 kontenierë të shpërndarë në 96 PGM nga të cilat 73 me nga 1 kontenier për mbetje mikse të pariciklueshme dhe 23 PGM për grumbullim të diferencuar prej të cilave 22 me përbërje 1+1 dhe 1 PGM me përbërje 3+1 kontenierë, në periudhën shtator – maj.

Grumbullimi i mbetjeve të mikse (përziera) dhe të diferencuara në mbetje të pariciklueshme dhe të riciklueshme në Zonën I-rë të shërbimit të bashkisë Lezhë do të kryhet në frekuenca të ndryshme në varësi të standardit, sezoni turistik dhe itinerarit të shërbimit në nën zona brenda kësaj zone, të cilat ndahen specifikisht si në tabelën më poshtë.

### **Frekuenca e grumbullimit Zona I**

#### **Periudha gjatë Sezoni Turistik**

Gjatë sezonit turistik do të angazhohen tre mjete siç janë përcaktuar, respektivisht 2 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziera ose të pariciklueshme (Mjetet 1 dhe 2) dhe 1 mjet për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme (Mjeti 3). Që të tre mjetet gjatë këtij sezoni do të punojnë në dy turne.

Nr.	Itinerari	Mjeti	Turni	Itinerare ST	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Dielë
1	Itinerari 1 ST	1	II	Lezhë SMT							
				Lezhë Lalm i Ri							
				Shëngjin Ishull Lezhë							
				Autostrada	-	-	-	-	-	-	-
2	Itinerari 2 ST	1	II	Lezhë Skënderbej							
				Lezhë Kodër Marlekaj							
				Lezhë Nënë Tereza							
				Lezhë Gurrë							
				Lezhë Besëlidhja							
				Lezhë Spitali							
				Lezhë Shehër							
3	Itinerari 3	2	I	Shëngjin Qendër							

	ST										
				Shëngjin Periferi							
4	Itinerari 4 ST	2	II	Shëngjin Qendër							
				Shëngjin Ishull Shëngjin							

Tabela 21: Frekuenca e shërbimit gjate Sezoni Turistik për grumbullimin e mbetjeve të pariciklueshme

### Periudha Jashtë Sezoni Turistik

Gjatë periudhës jashtë sezonit turistik (shtator – maj) do të angazhohen tre mjete; respektivisht 2 mjete për grumbullimin e mbetjeve të përziera ose të pariciklueshme (Mjetet 1 dhe 2) dhe 1 mjet për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme (Mjeti 3). Që të tre mjetet gjatë këtij sezoni do të punojnë në një turn.

Nr	Itinerari	Mjeti	Turni	Itinerare JS	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Djelë
5	Itinerari 1 JS	1	I	Lezhë SMT							
				Lezhë Lalm i Ri							
				Shëngjin Ishull Lezhë							
				Shëngjin Qendër							
6	Itinerari 2 JS	1	I	Shëngjin Periferi							
				Shëngjin Ishull Shëngjin							
				Autostrada							
				Shëngjin Qendër							
7	Itinerari 3 JS	2	I	Lezhë Skënderbej							
				Lezhë Kodër Marlekaj							
				Lezhë Nënë Tereza							
				Lezhë Gurrë							
				Lezhë Besëlidhja							
				Lezhë Spitali							
				Lezhë Shehër							
				Shëngjin Qendër							

Tabela 22: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të pariciklueshme Jashtë Sezonit Turistik

**Periudha gjatë Sezonit Turistik**

Nr.	Itinerari	Mjeti	Turni	Itinerare ST	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Dielë
8	Itinerari R 1 ST	3	I	Lezhë Skënderbej							
				Lezhë Kodër Marlekaj							
				Lezhë Nënë Tereza							
				Lezhë Gurrë							
				Lezhë Besëlidhja							
				Lezhë Spitali							
				Autostrada							

Tabela 23: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme gjatë Sezonit Turistik në Lezhë qytet

Nr.	Itinerari	Mjeti	Turni	Itinerare ST	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Dielë
9	Itinerari R 2 ST	3	II	Shëngjin							

Tabela 24: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme gjatë Sezonit Turistik në Shëngjin qytet.

Nr.	Itinerari	Mjeti	Turni	Itinerare ST	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Dielë
10	Itinerari R JS	3	I	Lezhë Skënderbej							
				Lezhë Kodër Marlekaj							
				Lezhë Nënë Tereza							
				Lezhë Gurrë							
				Lezhë Besëlidhja							
				Lezhë Spitali							
				Shëngjin Qendër							
				Autostrada							

Tabela 25: Frekuenca e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme Jashtë Sezonit Turistik në Lezhë dhe Shëngjin qytet

**Zona e II-të e shërbimit**

Autoriteti që do të ofrojë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë do të furnizojë dhe vendose në sistem **288 kontenierë** për Zonën e II-të ( 208 kontenierë për mbetje të përziera dhe 80 kontenierë për mbetjet të riciklueshme të thata) të shpërndarë në **178 pika** sipas itinerareve të Pikave për Grumbullimin e Mbetjeve siç janë paraqitur në tabelat në vijim dhe hartat shoqëruese Aneksi 2.

Gjithashtu gjatë periudhës së ofrimit të shërbimit do të rishikohet numri, shpërndarja e Pikave të grumbullimit të Mbetjeve dhe numri i kontenierëve kur vlerësohet e nevojshme, për të përmirësuar efektivitetin e organizimit të shërbimit dhe optimizimin e kostove.

Sistemi me 1 dhe 2 rryma	Pa riciklim		Me riciklim			Nr. Kont	Nr. Pikave
	1	2	1+1	2+1	3+1		
<b>Përbërja e pikave</b>	1	2	1+1	2+1	3+1		
<b>Kolsh</b>	26	3	11	2	0	<b>57</b>	<b>39</b>
<b>Zejmen</b>	29	0	32	5	3	120	70
<b>Shënkoll</b>	38	4	18	7	2	111	69
<b>TOTALI ZONA II</b>	93	7	61	14	5	288	178

Tabela 26: Nr. i PGM dhe Nr. i kontenierëve në sistemin e grumbullimit të diferencuar

Numri i kontenierëve do të dyfishohet në zonën e plazhit në njësinë Shënkoll gjatë muajve qershor – gusht për të përballuar gjenerimin e shtuar të mbetjeve nga fluksi i pritshëm i turistëve në këtë zonë.

#### Frekuenca e grumbullimit Zona II

Grumbullimi i mbetjeve të pariciklueshme dhe të riciklueshme të thata në Zonën II të shërbimit të bashkisë Lezhë do të kryhet në një frekuencë 2 herë jave për 52 jave gjatë gjithë vitit sipas itinerareve si më sipër. Grafiku i grumbullimit respektivisht për mbetjet e pariciklueshme dhe të riciklueshme paraqitet si më poshtë vijon:

#### Grafiku i grumbullimit të mbetjeve të pariciklueshme:

Itinerari	Hene	Marte	Merkure	Enjte	Premte	Shtune	Diele
Itinerari 1	X			X			
Itinerari 2		X			X		
Itinerari 3			X			X	

#### Grafiku i grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme:

Itinerari	Hene	Marte	Merkure	Enjte	Premte	Shtune	Diele
Itinerari 1	X			X			
Itinerari 2		X			X		

### Zona e III-të e shërbimit

Autoriteti që do të ofroje shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Lezhë do të furnizojë dhe vendose në sistem **414 kontenierë** për Zonën e III-të ( 340 kontenierë për mbetje të përziera dhe 74 kontenierë për mbetjet te riciklueshme te thata) të shpërndarë në **250 pika** sipas itinerareve të Pikave për Grumbullimin e Mbetjeve siç janë paraqitur në tabelat në vijim dhe hartat shoqëruese Aneksi 2.

- **Frekuenca e shërbimit në këtë zone do të jete 1 here në jave për secilën Nj. A.**

KM	Ungrej	Dajç	Blinisht	Kallmet	Balldre
<b>PGM</b>	55	37	25	48	85
<b>Kont Total</b>	<b>85</b>	<b>57</b>	<b>48</b>	<b>83</b>	<b>141</b>

Tabela 27: Nr. i PGM dhe Nr. i kontenierëve në sistemin e grumbullimit të diferencuar

Një paraqitje e shpërndarjes së kontenierëve për të gjithë bashkinë për të gjithë periudhën e planit jepet në tabelën vijuese:

	PGM	Kontenierë	PGM	Kontenierë	PGM	Kontenierë
	2017	2017	2018	2018	2019	2019
<b>Zona I</b>	192	321	192	321	192	321
<b>Zona II</b>	178	288	178	310	178	331
<b>Zona III</b>	250	414	250	414	250	414
	<b>620</b>	<b>1,023</b>	<b>620</b>	<b>1,045</b>	<b>620</b>	<b>1,066</b>

Tabela 28: Ndarja e kontenierëve dhe pikave të grumbullimit sipas zonave të shërbimit.

### Projeksioni për riciklimin

Mbi bazën e treguesve të rezultateve si më sipër si dhe të objektivave strategjike kombëtare për reduktimin e mbetjeve nëpërmjet ndarjes në burim dhe nxitjes së riciklimit dhe kompostimit, janë llogaritur projeksionet që paraqiten më poshtë.

Zona	Operacioni		2017	2018	2019	2020	2021
I	Mbetje të riciklueshme të thata	ton/vit	3,042	3,091	3,141	3,192	3,244
	<b>Planifikuar për Riciklim</b>	Mbulim	74	74%	80%	85%	90%
		Objekt	10%	25%	35%	50%	65%
	Sasia e Ricikluar	ton/vit	225	572	879	1357	1898

Tabela 29: Rezultati i riciklimit për Zonën e I-rë.

Zona II	Operacioni		2017	2018	2019	2020	2021
	Mbetje të riciklueshme të thata	ton/vit	1,147	1,168	1,189	1,211	1,233
	<b>Planifikuar për Riciklim</b>	Mbulim	54%	54%	65%	73%	80%



	Objekt	10%	25%	35%	50%	65%
Sasia e Ricikluar	ton/vit	62	158	270	442	641

Tabela 30: Rezultati i riciklimit për Zonën e II-të.


Zona III	Operacioni		2017	2018	2019	2020	2021
	Mbetje të riciklueshme të thata	ton/vit	1,135	1,156	1,177	1,198	1,220
	<b>Planifikuar për Riciklim</b>	Mbulim	0	26%	37%	45%	60%
		Objekt	10%	25%	35%	50%	65%
	Sasia e Ricikluar	ton/vit	0	75	152	270	476

Tabela 31: Rezultati i riciklimit për Zonën e III-të.

Bashkia Lezhe	Operacioni		2017	2018	2019	2020	2021
	Mbetje të riciklueshme të thata	ton/vit	5,325	5,416	5,508	5,602	5,697
	<b>Planifikuar për Riciklim</b>	Mbulim	42%	51%	60%	68%	76%
		Objekt	10%	25%	35%	50%	65%
	Sasia e Ricikluar	ton/vit	224	691	1,156	1,904	2,814

Tabela 32: Rezultati i përgjithshëm i riciklimit për bashkinë Lezhë.

Grafiku në vijim ilustron sasinë e mbetjeve që do të riciklohen në raport me totalin e projeksionit të mbetjeve që planifikohet të gjenerohen në Zonën e I-rë të shërbimit në bashkinë Lezhë.



Grafiku 8: Grafiku Projeksioni i mbetjeve që riciklohen në raport me mbetjet që gjenerohen, Zona I në bashkinë Lezhë, 2017-2021.

Përsa i përket llojit të mbetjeve të cilat riciklohen sipas % të përbërjes së tyre dhe sipas objektivit të vendosur me sipër (shih kapitullin 6) sasinë e mbetjeve të riciklueshme të cilat rikuperohen janë si në tabelën në vijim;

Sasia e ricikluar e mbetjeve sipas llojit					
Bashkia Lezhë	2017	2018	2019	2020	2021

letër/karton	138.5	352.1	501.3	728.3	962.8
plastike	69.2	176.0	250.6	364.1	481.4
qelq	292.9	744.7	1,060.3	1,540.5	2,036.8
metal	32.0	81.2	115.7	168.1	222.2
Mbetje të riciklueshme gjithsej	532.6	1,354.1	1,927.9	2,801.0	3,703.2

Tabela 33: Sasia e rikuperuar e mbetjeve sipas llojit

## 8.2. Sistemi i mbledhjes dhe transportit të mbetjeve

### Skemat e mbledhjes dhe transportit të mbetjeve

Në harkun kohor të këtij Plani dhe në përputhje me kërkesat ligjore, skemat e organizimit të këtij shërbimi do të bazohet mbi parimet e Grumbullimit, Reduktimit, Ripërdorimit dhe Riciklimit.

#### Viti 2017 - 2018

Në vitin 2017, bashkia e Lezhës do të fillojë me:

1. Aplikimin e skemës së ndarjes në burim dhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në të gjitha zonat urbane të cilat janë të aksesueshëm me rrugë të asfaltuara në 2 rryma:
  - a. Të riciklueshme të thata Letër/Karton, plastikë, metale (alumin), qelq, të tjera;
  - b. Të përzjera, të riciklueshme të njoma dhe të pariciklueshme.
2. Vazhdimin e shërbimit nëpërmjet grumbullimit të pa diferencuar të mbetjeve bashkiake në zonat rurale të të fshatrave të NjA-ve.

Në mënyrë skematike organizmi i shërbimit në vitin 2017 paraqitet si në figurën që vijon.




Figura 7: Paraqitja skematike e organizimit të shërbimit, viti 2017 - 2018.

Në vitin 2018 bashkia do të fillojë pilotimin e grumbullimit derë më derë me qese të mbetjeve të riciklueshme të thata në zonat rurale të fshatrave (aty ku nuk shtrihet rrjeti i kontenierëve për grumbullimin e diferencuar).

## Viti 2019 - 2021

Në intervalin kohor të planifikimit 2019 - 2021, skema e grumbullimit të diferencuar nëpërmjet rrejtit të kontenierëve do të konsolidohet në të gjitha zonat urbane të shërbimit të bashkisë.

Në vitin 2019 bashkia do të zgjerojë zonën e grumbullimit derë më derë me qese të mbetjeve të riciklueshme të thata në zonat rurale të fshatrave.

Krahas, po në këtë vit, bashkia ka planifikuar të pilotojë kompostimin e rregulluar në njësi të vogël (mbi bazë familje ose grup familjesh dhe biznesesh) në zona të zgjedhura rurale.




Figura 8: Paraqitja skematike e organizimit të shërbimit, viti 2019 – 2021.

Mbi bazën e mënyrës së organizimit të shërbimit si më sipër, Plani në vijim përmban planifikimin e të gjitha elementëve përbërës financiar, përfshi gjenerimin, mjetet, kostot dhe tarifat e shërbimit.

### 8.3. Menaxhimi i reduktimit të mbetjeve

Reduktimi i mbetjeve përfshin procesin e selektimit dhe përpunimit të mbetjeve të riciklueshme të thata (leter, karton, plastike, metale) dhe të mbetjeve të riciklueshme të njoma (të biodegradueshme) dhe përgatitjen e tyre për tregun e riciklimit.

Reduktimi i mbetjeve nëpërmjet këtyre proceseve zhvillohet me efektivitet kur ka infrastrukturën e nevojshme për ndarjen në burim dhe grumbullimin e diferencuar, infrastrukturën për selektimin, ndarjen në rryma dhe përgatitjen për tregun e industrisë së interesuar, i mbështetur nga një komponent i fuqishëm dhe i vazhdueshëm ndërgjegjësimi dhe edukimi të popullsisë.

Bashkia e Lezhës ka marrë përsipër që të investojë në ngritjen e infrastrukturës së ndarjes në burim, grumbullimit të diferencuar dhe ndërgjegjësimin; ndërsa kërkon të gjejë mënyra inovative që do ti sigurojnë infrastrukturën për selektimin dhe përgatitjen e produkteve për tregun e riciklimit në mënyrë që të përmbushi detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni dhe Strategjia dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve.

#### 8.3.1. Versionet e përkohshme të reduktimit të mbetjeve

##### Objekti i selektimit të mbetjeve

### **1. Kontraktimi i procesit tek operatorët privatë si pjesë e shërbimit të grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve.**

Në kuadër të këtij opsioni, bashkia i ka kërkuar operatorëve private të sigurojnë me nënkontratë ose qiramarrje, nëse përndryshe nuk e zotërojnë atë vetë, një objekt në të cilin të bëjnë selektimin dhe përpunimin e mbetjeve të riciklueshme që do të mblidhen nëpërmjet sistemit të grumbullimit të diferencuar. Bashkia do të mbulojë kostot e grumbullimit dhe transportit për në dha nga objekti i selektimi, ndërsa kostot e selektimit dhe përpunimin do të sigurohen nga operatori dhe do të mbulohen nga të ardhurat prej shitje së materialit të riciklueshëm.

### **2. Rivënia në funksionim e Qendrës për Selektimin e Mbetjeve të Riciklueshme në Lezhë.**

Një opion tjetër i mundshëm dhe i përkohshëm do të jetë rivënia në funksion e Qendrës për Selektimin e Mbetjeve të Riciklueshme i cili është ndërtuar nga bashkia në bashkëpunim më DLDP disa vite më parë. Ky opion do të kërkojë disa investime nga buxheti i bashkisë ose me mbështetjen e ndonjë donator të mundshëm për të rifreskuar pajisjet dhe instalimet e këtij objekti dhe aplikimin e një skeme menaxhimi tërheqëse për operatorin/operatorët privat të shërbimit të grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve. Si dhe në rastin më sipër, për të lehtësuar administrimin e kësaj qendre, Bashkia do të mbulojë kostot e grumbullimit dhe transportit për në dha nga objekti i selektimi, ndërsa kostot e selektimit dhe përpunimin do të sigurohen nga operatori i cili do të mbulojë ato nga të ardhurat prej shitje së materialit të riciklueshëm.



Figura 9: Qendra për selektim dhe riciklimi (Lezhë)

Qendra Selektimit do të shërbejë për depozitimin e përkohshëm të kësaj kategorie, ndarjen e tyre në rryma të veçanta, paketimin dhe përgatitjen për tregun e industrisë së riciklimit. Shpenzimet e selektimit dhe përpunimit do të mbulohen nga të ardhurat prej shitjes së materialit të riciklueshëm.

Produkti i kësaj qendre do të jenë materialet e riciklueshme të ndara sipas kërkesave të tregut dhe që përbehen kryesisht në:

1. Letër – karton;
2. Plastike me densitet të lartë;
3. Plastikë me densitet të vogël
4. Metale, kryesisht alumin (kanoçe pijesh freskuese etj.),

## 5. Qelq (pasi të jetë gjetur tregu i shitjes së këtij produkti)

Fotot në vijim ilustrojnë procesin dhe produktet nga selektimi dhe përgatitja për riciklim e materialeve që janë mbledhur nëpërmjet sistemi të grumbullimit të diferencuar në bashkinë Lezhë).

### 8.3.2. Versioni i qëndrueshëm i reduktimit të mbetjeve

#### *Objekti i Reduktimit të Mbetjeve*

Ky opsion ngrihet mbi ndërtimin e dhe funksionimin e Objektivit për Reduktimin e Mbetjeve i planifikuar si një qendër komplekse për trajtimin e mbetjeve për riciklim dhe kompostim, trajtimin e mbetjeve voluminoze, si dhe stacion transferimi për optimizimin e kostove të transportit. Plani ka parashikuar ndërtimin e këtij objekti në tre faza, dy prej të cilave do të zhvillohen në kuadrin kohor 2017 – 2021, ndërsa faza e tretë përtej horizontit të këtij plani. Financimi i ORM planifikohet të mundësohet nga burimet e bashkisë, buxheti i shtetit dhe donacione.

Bashkia do të mundësojë menaxhimin e këtij objekti duke zgjedhur një prej instrumenteve:

- Një ndërmarrje bashkiake për shërbime publike;
- Me sipërmarrje me një apo konsorcium operatorësh privat, ose
- Në kuadër të një Partneriteti Publiko – Privat.

Në çdo rast, bashkia do ta paraprijë zgjedhjen e saj mbi bazën e një Studimi Fizibiliteti dhe plani menaxhimi.

ORM ka për qëllim që të sigurojë kushtet teknike për reduktimin e mbetjeve nëpërmjet selektimit të mbetjeve të riciklueshme të thata, kompostimin e mbetjeve të riciklueshme të njoma, administrimin e mbetjeve voluminoze dhe optimizimin e kostove të transportit. Sipërfaqja e tokës e kërkuar për zhvillimin e ORM është rreth 1.2 ha, ndërsa kosto totale e ndërtimit dhe pajisjeve vlerësohen në rreth 3.5 milion Euro.

Në terma të përgjithshëm, ORM do të organizohet si në skicën që vijon:




Figura 10: Skica e organizimit të ORM

Bashkia ka zhvilluar bisedime me Qeverinë Qendrore por edhe me donator për të eksploruar mundësinë e financimit të ORM. Bashkia e kupton se kosto e ndërtimit të këtij objekti është përtej burimeve të veta financiare, por ajo do të vazhdojë të synojë gjetjen e burimeve të tjera, të cilat do të bëjnë të mundur ndërtimin e këtij objekti.

Objekti planifikohet të ndërtohet në tre faza:

- Faza e parë (2017 – 2018) do të përfshijë :
  - o Gjetjen dhe përvetësimin e sipërfaqes së tokës;
  - o Punimet kryesore të ndërtimit, përfshirë rrethimin, ndriçimin, drenazhimin, rrugët e qarkullimit dhe sheshet e operimit;
  - o Pajisjet për stacionin e transferimit, dhe hapësirat e selektimit për mbetjeve e riciklueshme të thata.
- Faza e dytë (2019 – 2020) do të përfshijë:
  - o Ndërtimin dhe pajisjen e impiantit të kompostimit;
- Faza e tretë (përtej vitit 2021), do të përfshijë:
  - o Ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të plotë të selektimit të mbetjeve të riciklueshme.

Tabela në vijim pasqyron në mënyrë të përmblendhur shpërndarjen e kostove dhe aktiviteteve për zhvillimin në faza të Objektivit për Reduktimin e Mbetjeve.

<b>Faza e I-re (2017 - 2018)</b>		Shuma Euro
Organizimi i sheshit Njësia e selektimit të mbetjeve të riciklueshme	Punime ndërtimi	642,450
	Pajisje të fikse	282,400
	Pajisje të lëvizshme	350,500
	Projektim, VNM, Supervizimi	96,367.50



	<b>Shuma Faza e I-re</b>	<b>1,371,718</b>
--	--------------------------	------------------

<b>Faza e II-te (2018-2019)</b>		Shuma Euro
Njësia e kompostimit	Punime ndërtimi	340,000
	Pajisje të lëvizshme	179,500
	<b>Shuma Faza e II-te</b>	<b>519,500</b>


<b>Faza e trete (përtej 2021)</b>		
Njësia e selektimit te mbetjeve të riciklueshme nga mikse	Punime ndërtimi	106,000
	Pajisje të fikse	1,258,000
	Pajisje të lëvizshme	145,000
	<b>Shuma Faza e III-te</b>	<b>1,509,000</b>

<b>ORM</b>	<b>Shuma Totale</b>	<b>3,400,218</b>
------------	---------------------	------------------

*Përmbledhje e kostove për ndërtimin në faza të ORM*

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2017, bashkia do të planifikojnë dhe ekzekutojë hartimin e një Studimi Fizibiliteti të hollësishëm dhe të një raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për këtë objekt, krahas identifikimit dhe përvetësimit të vendit me të përshtatshëm për ndërtimin e objektit.

Vënia në funksionim e objektit do të kushtëzojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, fillimisht (deri në vitin 2021) me dy rryma (të riciklueshme të thata dhe të përziera; dhe mbas vitit 2021 në tre rryma, respektivisht, të riciklueshme të thata, të riciklueshme të njoma dhe të përziera. Skema në vijim pasqyron zhvillimin e ORM si dhe të skemës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve.





Ndërtimi Objektivit të Trajtimit të Mbetjeve dhe organizmi dhe shtrirja e grumbullimi të diferencuar të mbetjeve fillimisht në dy rryma dhe në vijim në tre rryma duke u shtrirë gradualisht në të gjithë territorin e bashkisë, do të bëjë të mundur reduktimin e mbetjeve që do të depozitohen në landfill mbas vitit 2021 minimalisht në 55% të sasisë që do të gjerohet në territorin e bashkisë Lezhë.

## 9. Plani financiar i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve

### 9.1. Kosto e shërbimit 2017-2021

Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve ndahet sipas llojit të shpenzimit dhe veprimtarisë së shërbimit që kryhet përmes tij, në zërat e mëposhtëm:

#### A. Kosto operative

- a. Kostot e mirëmbajtjes: mjete të shërbimit
- b. Kostot e mbledhjes: karburant i përdorur gjatë shërbimit
- c. Kosto transporti: karburant i përdorur gjatë shërbimit
- d. Kosto depozitimi: tarifa për trajtimin e mbetjeve në landfill
- e. Kosto personeli: shoferë dhe punëtorë
- f. Kosto amortizimi: mjete të shërbimit
- g. Kosto larje dhe dezinfektim: për kontenierët

#### B. Kosto kapitale

- a. Kosto e blerjes së mjeteve të shërbimit

Në realizimin e shërbimit marrin pjesë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, dhe drejtues e nëpunës specialistë të bashkisë, shpenzimet për të cilët vlerësohen në masën 8 % të koston operative dhe përfshihen në zërin:

#### C. Kosto administrative

Bazuar në objektivin e Bashkisë Lezhë për të dhënë shërbimin me nen kontraktim tek një operator privat, i cili do të zgjidhet nëpërmjet proceduarve ligjore të prokurimit publik, mbi koston operative të shërbimit është llogaritur e ardhura neto e pritur, në masën 10 %; ky shpenzim përfshihet në zërin e koston:

#### D. Të ardhura neto

Vlera gjithsej e koston së shërbimit llogaritet me TVSH në masën 20 % të koston operative rënduar me koston administrative dhe të ardhurat e pritura neto.

#### E. Tatim mbi Vlerën e Shtuar

Llogaritja e kostove të mësipërme është në përputhje me metodën e Llogaritjes së Koston së Plotë (Full Cost Accounting), dhe në zbatim të Planit Teknik dhe Operacional të realizimit të shërbimit. Këto kosto paraqiten:

- a. për çdo zonë të bashkisë Lezhë, në funksion të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve,

- b. për çdo itinerar të përshkruar nga kamioni i mbledhjes së mbetjeve,
- c. sipas llojit të mbetjeve: (i) të riciklueshme, të (ii) të pariciklueshme dhe (iii) mikse.

#### 9.1.1. Kosto operative të shërbimit

Kostot operative vjetore të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për vitet 2017-2021, me TVSH, paraqiten në tabelën në vijim, të ndara sipas zonave të shërbimit dhe gjithsej për bashkinë Lezhë.

Zonat e shërbimit	Shpenzime operative të planifikuara lekë/vit				
	2017	2018	2019	2020	2021
Lezhë-Shëngjin	44,926,898	47,173,243	49,531,905	52,008,500	54,608,925
Kolsh-Zejmen-Shënkoll	15,851,435	16,644,006	17,476,207	18,350,017	19,267,518
Balldre-Kallmet-Dajç-Blinisht-Ungrej	14,405,155	15,125,413	15,881,684	16,675,768	17,509,556
<b>Bashkia Lezhë</b>	<b>75,183,488</b>	<b>78,942,662</b>	<b>82,889,795</b>	<b>87,034,285</b>	<b>91,385,999</b>

Tabela 34: Tabela e shpenzimeve operative

Një vlerë shtesë në masën 5 % është zbatuar mbi koston operative të shërbimit duke filluar nga viti 2018; kjo vlerë ka për qëllim të korrigojë vlerat në vite të zërave të kësaj kostoje, llogaritur mbi bazën e çmimeve aktuale, me inflacionin mesatar vjetor të mundshëm, si dhe me shumën e një fondi rezervë i cili duhet të mbulojë shpenzime të papritura ose në rritje për arsye të tjera të paparashikueshme.

Një pjesë e veçantë e koston operative të shërbimit është veprimtaria e larjes dhe dezinfektimit të kontenierëve, e cila është planifikuar të zbatohet në intervale kohore të rregullta, dy deri gjashtë javore, në varësi të ngarkesës me kontenierë të një itinerari të mbledhjes së mbetjeve, të riciklueshme apo të pariciklueshme. Më poshtë, paraqitet tabela përmbledhëse e këtij shërbimi, me nen zërat përkatës:

Larje e dezinfektim kazanësh	Zona I	Zona II	Zona III
Kosto e mirëmbajtjes	455,200	455,200	455,200
Kosto e mbledhjes	495,896	394,465	437,505
Kosto larje dhe dezinfektim	264,439	202,769	240,396
Kosto personeli	1,390,232	508,721	591,386
Kosto amortizimi	301,392	301,392	301,392
<b>Gjithsej</b>	<b>2,907,160</b>	<b>1,862,547</b>	<b>2,025,879</b>

Tabela 35: Tabela e qendrave të koston.

Tabela e qendrave të koston

Kosto vjetore e amortizimit të mjeteve të shërbimit është një nga zërat më të rëndësishëm të kostos operative; për llogaritjen e saj është marrë për bazë Udhëzim Nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006", i Ministrisë së Financave, i cili rrjedh nga VKM nr. 401, viti 1989 me të njëjtin qëllim.

### 9.1.2. Kosto kapitale

Kosto kapitale përfaqëson investimin në automjete dhe mjete për realizimin e shërbimit, të cilat përfshijnë kontenierë dhe kamionë që do të përdoren për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve.

Për realizimin e shërbimit në vitet 2017-2019 nevojiten kamionë teknologjik, me vetëshkarkim, të tonazhit 12 dhe 15 ton, si dhe kamionë me vinç për mbledhjen e kontenierëve me qëllim larjen dhe dezinfektimin e rregullt të tyre, me kapacitet maksimal mbajtës prej 20 kontenierësh. Vlera e investimit për kamionët paraqitet në tabelën në vijim, e ndarë në çdo zonë dhe sipas karakteristikat më kryesore të tyre.

Automjete sipas zonave	Kamionë teknologjik			Kamionë me vinç		
	Tonazhi	Sasia	Vlera lekë	C kontenierë	Sasia	Vlera lekë
Lezhë-Shëngjin	12	2	8,400,000	20	1	2,184,000
	15	1	4,200,000			
Kolsh-Zejmen-Shënkoll	15	1	4,200,000	20	1	2,184,000
	10	1	3,864,000			
Balldre-Kallmet-Dajç-Blinisht-Ungrej	15	2	8,400,000	20	1	2,184,000
<b>Gjithsej automjete</b>		<b>7</b>	<b>29,064,000</b>		<b>3</b>	<b>6,552,000</b>

Tabela 36: Tabela e kostove të makinave

Në mënyrë të ngjashme paraqitet në tabelën e mëposhtme dhe vlera e investimit për kontenierë, sipas numrit të tyre në secilën zonë. Një shtesë investimi është planifikuar për zonën e dytë Kolsh-Zejmen-Shënkoll, në vitet 2018 dhe 2019, në bazë të nevojës së vlerësuar për kontenierë të saj.

	2017	Vlera lekë	2018	Vlera shtesë lekë	2019	Vlera shtesë lekë
Lezhë-Shëngjin	417	8,757,000				
Kolsh-Zejmen-Shënkoll	288	6,048,000	22	462,000	21	441,000
Balldre-Kallmet-Dajç-Blinisht-Ungrej	414	8,694,000				
<b>Gjithsej Bashkia Lezhë</b>	<b>1,119</b>	<b>23,499,000</b>	<b>22</b>	<b>462,000</b>	<b>21</b>	<b>441,000</b>
<b>Gjithsej vlera kazanë</b>	<b>1,162</b>	<b>24,402,000</b>				


Tabela 37: Tabela e kostos se kontenierëve

Rekomandohet që fushata e edukimit dhe ndërgjegjësimit të kryhen nga bashkia ose nga agjentë të tjerë të ndryshëm nga operatori i dhënies së shërbimit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve.

### 9.1.3. Kosto shërbimi për njësi


Grafikët e mëposhtëm paraqesin të përmblodhur kostot gjithsej për njësi të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në secilën nga zonat e bashkisë dhe për bashkinë në tërësi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kostot në rritje për ton mbetje në vit që mbledhen në bashkinë Lezhë.



Grafiku 9: Kosto totale të shërbimi

Grafiku i mëposhtëm paraqet kostot në rritje për banor në vit, në bazë të numrit të banorëve që marrin shërbim në bashkinë Lezhë.



Grafiku 10: Kosto totale shërbimi për banorë.

## 9.2. Planifikimi i mbulimit të kostove

Qëndrueshmëria financiare e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve do të mbështetet në faktorët e mëposhtëm:

1. efektivitetin e organizimit të shërbimit,
2. eficiencën e kostos së shërbimit,
3. efektivitetin e monitorimit të shërbimit,
4. sistemin e tarifimit nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit,
5. efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e shërbimit.

Secili prej tyre është faktor kyç për të gjithë ciklin e menaxhimit financiar të shërbimit; kjo do të thotë se mbarëvajtja në lidhje me njërin mund të ndihmojë të gjithë ciklin, sikurse mos përmbushja e tij mund ta pengojë atë.

Të katër faktorët të cilët përcaktohen nga efektiviteti dhe eficiencën, janë parime udhëheqëse të planifikimit të shërbimit të kryer në Bashkinë Lezhë për vitet 2017-2021; kjo do të thotë se sistemi i organizimit të shërbimit, monitorimit të tij dhe i mbledhjes së të ardhurave në këtë plan janë parashikuar të sigurojnë efektivitet të ciklit të plotë të shërbimit dhe eficiencën të kostos së tij. Nga ana tjetër, zbatimi i këtyre sistemeve do të jetë i lidhur ngushtë me aftësinë e nëpunësve administrativë të Bashkisë, punonjësve të operatorit privat që do të nënkontraktohet për realizimin e shërbimit si dhe të shoferëve dhe punëtorëve të terrenit; për rrjedhojë, qëndrueshmëria financiare do të varet nga aftësia e burimeve njerëzore për përmbushjen e këtyre faktorëve.

Sa i përket faktorit të katërt, një sistem tarifimi nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit, do të ketë një strukturë të mbështetur në shtyllat e më poshtme:

- Ndotësi paguan;
- Shpërndarje e drejtë e barrës së kostos ndërmjet grupeve të subjekteve gjenerues;

- Shpërndarje e drejtë e barrës së kostos brenda për brenda grupeve të subjekteve gjenerues
- Subjektet gjeneruese të cilat paguajnë tarifë rëndohen përkohësisht me barrën e kostos së subjekteve gjenerues të cilët nuk paguajnë;
- Fushata ndërgjegjësuere dhe edukuese për mbrojtjen e mjedisit dhe masa shtrënguese për të paguar tarifën ndërmerren nga Bashkia me objektiva të përcaktuara të masës dhe kohës së rritjes së % së subjekteve gjeneruese që paguajnë.

Këto shtylla përfaqësojnë parime dhe politika vendore të domosdoshme për të siguruar një sistem tarifimi i cili mbulon vlerën e plotë të kostos së shërbimit. Në mënyrë të ngjashme me grupin e parë të faktorëve, edhe në këtë rast, aftësia e burimeve njerëzore të bashkisë për të vënë në jetë këtë sistem është përcaktuese për qëndrueshmërinë financiare të shërbimit, më shumë se sa planifikimi i tij.

Në mënyrë të veçantë, përmbushja e objektivave të rritjes së % së subjekteve gjenerues që paguajnë është thelbësore për të siguruar zbatimin afatgjatë të këtij sistemi tarifimi, i cili bazohet në mirëkuptimin e banorëve që paguajnë për të mbajtur përkohësisht barrën e banorëve që nuk paguajnë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e nevojshme për përlogaritjen e një tarife mesatare në vite për subjektet pagues për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

	2017	2018	2019	2020	2021
<b>Kosto e planifikuar e shërbimit</b>	75,183,488	78,942,662	82,889,795	87,034,285	91,385,999
% e planifikuar e realizimit të të ardhurave	70%	75%	80%	85%	90%
Kosto e planifikuar e shërbimit për t'u shpërndarë	107,404,982	105,256,883	103,612,244	102,393,276	101,539,999
Numri i familjeve *	19,225	19,321	19,417	19,515	19,612
Numri i bizneseve **	204	208	212	216	221
Numri i institucioneve	33	33	33	33	33

\* Numër i përafshirë për madhësi mesatare të familjes, 4 anëtarë

\*\* Numër i përafshirë mbi bazën e rritjes mesatare vjetore të PBB-së në vend, 2%

Barra e kostos së shërbimit ndahet midis familjeve, bizneseve dhe institucioneve, subjekte gjenerues të mbetjeve urbane, në masën si më poshtë:

- 70% nga grupi i subjekteve "Familje",
- 25% nga grupi i subjekteve "Biznese",
- 5% nga grupi i subjekteve "Institucione".

Kjo politikë e shpërndarjes së barrës për mbulimin e kostove të shërbimit bazohet në praktikën më të mira brenda dhe jashtë vendit. Sipas tyre, ndotësi paguan, që do të thotë se barra shpërndahet ndërmjet grupeve të subjekteve sipas masës në të cilën ata gjenerojnë mbetje. Rrjedhimisht pjesa me e madhe e kostos do të mbulohet nga familjet, dhe pjesa më e vogël nga institucionet.

Më tej, me qëllim mbledhjen e plotë të kostos së shërbimit, barra e kostos për t'u shpërndarë tek subjektet pagues, ose niveli i faturimit, është në çdo vit i korigjuar me përqindjen e planifikuar të


realizimit të të ardhurave, e cila fillon me 70 % në vitin e parë dhe arrin në 90 % të të ardhurave që mblidhen në vitin 2021. Këto objektiva janë vendosur nisur nga norma aktuale e realizimit të të ardhurave nga shërbimi, e cila është në nivelin rreth 59 %. Në këtë mënyrë barra e kostos është vazhdimisht më e lartë se kosto e shërbimit, por njëkohësisht ajo edhe zvogëlohet vazhdimisht. Për rrjedhojë, tarifat e subjekteve pagues janë në zbritje gjatë periudhës 2017-2021. Mbi bazën e politikave si më sipër, në tabelën në vijim parashtrohen tarifat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve për familjet, bizneset dhe institucionet në vitet 2017-2021.

Tarifa e planifikuar, lekë/vit:	2017	2018	2019	2020	2021
Familje	3,911	3,813	3,735	3,673	3,624
Biznese	131,624	126,462	122,045	118,244	114,960
Institucione	162,735	159,480	156,988	155,141	153,848

Sistemi i tarifimit lejon diferencimin e barrës edhe brenda për brenda grupeve të subjekteve, veçanërisht për bizneset dhe familjet.

Këtu, tarifa e bizneseve paraqitet e pa diferencuar për madhësinë e biznesit: i madh, i mesëm dhe i vogël, dhe gjithashtu e pa diferencuar në lidhje me llojin e biznesit: prodhues, tregtues, shërbimi apo kategori të tjera. Këto diferencime janë pjesë e politikave të bashkisë të cilat mund të vendosen në mirëkuptim me komunitetin e biznesit në territorin e saj.

Në grafikun e mëposhtëm, paraqitet prirja rënëse e tarifës vjetore të shërbimit për familjet, gjatë periudhës kohore 2017-2021.



Grafiku 11: Grafiku i tarifës vjetore e shërbimit

Është pjesë e politikave të Bashkisë Lezhë lehtësimi i barrës së tarifës së shërbimit për grupe të caktuara të subjekteve familjare ashtu si dhe për biznese të caktuara. Këto politika mund të ndërmerren si masa sociale ose si masa nxitëse për mbrojtjen e mjedisit.

- A. Kështu, për grupet e familjeve në nevojë të kategorive të ndryshme është e mundur caktimi i tarifës së shërbimit me vlerë të reduktuar ose përjashtimin nga detyrimi për të paguar tarifën; caktimi i një tarife të reduktuar është e mundur dhe për zonat rurale të bashkisë, si për shembull në njësi administrative më të thella.
- B. Për biznese të cilat angazhohen në veprimtari ricikluese ose ndërgjegjëse të banorëve për mbrojtjen e mjedisit mund të caktohet një tarifë me vlerë të reduktuar.

### 9.3. Bilanci financiar

Sistemi tarifor i parashtruar më sipër ka për objektiv mbulimin e kostos së shërbimit në masën 100 % me të ardhurat nga tarifa, duke filluar që në vitin e parë. Në tabelën që vijon janë paraqitur vlerat e të ardhurave të planifikuara për t'u realizuar nga tarifat e përlogaritura dhe sipas numrit të familjeve, bizneseve dhe institucioneve të vendosur në bashkinë Lezhë. Në fund të çdo viti, buxheti financiar i shërbimit duhet të rezultojë i balancuar, tërësisht me burime vendore të të ardhurave.

<b>Të ardhura të planifikuara për t'u realizuar</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
Familje	52,628,441	55,259,863	58,022,857	60,923,999	63,970,199
Biznese	18,795,872	19,735,665	20,722,449	21,758,571	22,846,500
Institucione	3,759,174	3,947,133	4,144,490	4,351,714	4,569,300
<b>Kosto e planifikuar për t'u mbuluar</b>	<b>75,183,488</b>	<b>78,942,662</b>	<b>82,889,795</b>	<b>87,034,285</b>	<b>91,385,999</b>
% e mbulimit të kostos nga të ardhura të veta	100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 38: Tabela e mbulimit të kostos

#### 9.3.1. Shpenzime mbështetëse

Përkrah kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, një fond shtesë është i nevojshëm të parashikohet për disa shpenzime mbështetëse të cilat kanë për qëllim përmbushjen e objektivave të të qëndrueshmërisë financiare. Këto shpenzime mbështetëse veprimtaritë bashkiake të mëposhtme:

##### 1. Ndërgjegjësim dhe edukimi i banorëve për mbrojtjen e mjedisit

Kjo veprimtari planifikohet të mbështesë rritjen e efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave të shërbimit nga subjektet pagues, në masën e përmbushjes së objektivave të vendosur në këtë drejtim, të paraqitur si më sipër. Plani i veprimit parashikon shpenzime vjetore shtesë gjatë gjithë periudhës 2017-2021, të cilat mund të shtrihen dhe në periudha të mëvonshme, në varësi të objektivave të mëtejshme të Bashkisë Lezhë.

##### 2. Ngritja e bazës së të dhënave të subjekteve pagues

Një bazë të dhënash mbi subjektet gjeneruese të mbetjeve, në formatin e një programi kompjuterik, është një instrument i domosdoshëm për vënien në jetë të sistemit të tarifimit të shërbimit të



menaxhimit të tyre dhe rritjes së efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave nga tarifa. Një identifikim i saktë i këtyre subjekteve: vendndodhjes së tyre, madhësisë e gjendjes financiare të tyre, llojit të aktivitetit në rast biznesi etj., i mundëson autoriteteve vendore ndjekjen e rasteve të subjekteve që nuk paguajnë dhe zbatimin efektiv të masave shtrënguese. Edhe në këtë rast, përveçse krijimit të një aseti vendor me vlerë afatgjatë, baza e të dhënave duhet t'i shërbejë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave të vendosur për rritjen e % së mbledhjes së të ardhurave të shërbimit, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.

